

lëvizje ishin përzier elementë reaksionarë fashistë, të cilët u orvatën ta përdornin atë si mjet për zbatimin e planeve të Italisë fashiste në Shqipëri. Komunistët që morën pjesë në lëvizje, ndonëse ishin të vendosur ta çonin deri në fund, nuk arritën të dilnin në krye të lëvizjes, ta përgatisnin atë në mënyrë të gjithanshme dhe ta pajisnin me një program të qartë politik. Të gjitha këto shkaktuan që kryengritja të përfundonte në një puç. Megjithatë, ajo ishte një shfaqje e zemërimit dhe e pakënaqësisë kundër regjimit shtypës çifligaro-borgjez. Ajo pati rëndësi politike dhe jehona e saj i kaloi kufijtë e Shqipërisë. Kundër masave terroriste, që mori Zogu pas shtypjes së kryengritjes, u ngrit opinionin demokratik brenda e jashtë vendit. Kryengritja, siç shkruante Ali Kelmendi, ishte «pagëzimi i zjarrit dhe guri i provës» për komunistët shqiptarë. «Këtë provë, ata e kaluan me nder dhe e treguan veten e tyre si vëllezër të denjë të komunistëve të vendeve të tjera»<sup>1</sup>.

### 3. ZGJERIMI I LËVIZJES KOMUNISTE DHE LUFTA KUNDËR RREZIKUT FASHIST NË VITET 1935—1939

Në vitet 30 lufta e popujve sovjetikë, të udhëhequr nga Partia Bolshevike me J. Stalinin në krye, për ndërtimin e shoqërisë socialiste u kurorëzua me fitore. Bashkimi Sovjetik u shndërrua në një fuqi të madhe industriale me një bujqësi të përparuar socialiste.

Ndërkaq, kriza e thellë ekonomike e viteve 1929-1933 e kishte tronditur nga themelet botën kapitaliste dhe i kishte acaruar shumë kontradiktat e saj. Për të kapërcyer gjendjen e vështirë, borgjezia imperialiste e mjaft vendeve doli në për-krahje të fashizmit, domethënë të diktaturës më reaksionare e terroriste, më shoviniste të kapitalit financiar. Një vatrë shumë e rrezikshme luftime u krijua në Gjermani me ardhjen e nazistëve në fuqi më 1933. Fashistët u hodhën me tërbim kundër lëvizjes punëtore, komuniste e demokratike dhe bënë përgatitje të ethshme për luftëra agresive. Rreziku i një luftime re botërore u shtua edhe më tepër me sulmin e Japonisë

---

1 A.Kelmendi. Raport dërguar Kominternit, 14 dhjetor 1936. AQP.

militariste kundër Kinës më 1931 dhe të Italisë fashiste kundër Abisinisë më 1935.

Botën po e kërcënonte rreziku fashist dhe rreziku i një lufte të re botërore. Fuqitë perëndimore të ashtuquajtura «demokratike» si Anglia, Franca dhe SHBA nuk morën asnjë masë efektive kundër këtij rreziku, por e ndihmuan militarizimin e vendeve fashiste dhe, me anën e politikës famëkeqe të «mosndërhyrjes», e nxitën agresionin fashist me qëllim që ta drejtonin kundër Bashkimit Sovjetik.

Vetëm qeveria sovjetike dhe partitë komuniste të vendeve të ndryshme luftuan me të gjitha forcat për t'u vënë fre agresorëve.

## **Kongresi VII i Internacionales Komuniste**

Gjendja ndërkombëtare shtronte përpara partive komuniste të botës detyra të reja.

Kongresi VII i Internacionales Komuniste që u mbledh në Moskë në korrik 1935 theksoi nevojën për të zhvilluar më gjerë luftën kundër sulmit të kapitalit dhe të fashizmit. Lidhur me këtë, Kongresi vuri detyrë të luftohej për të krijuar frontin unik të klasës punëtore kundër fashizmit, duke siguruar njësinë e veprimit të punëtorëve dhe, mbi këtë bazë, të formohej fronti i gjerë popullor antifashist. Për t'i përmbushur këto detyra ishte e nevojshme që partitë komuniste të kapërcenin një varg dobësish, si shfaqjet e punës sektare me masat, të përmirësonin metodat e agjitacionit e të propagandës, të hidheshin në aksione të guximshme revolucionare. Kongresi u bëri thirrje gjithë popujve të mobilizonin forcat për t'u ardhur në ndihmë vendeve që luftonin për pavarësinë e tyre kundër zgjedhës imperialiste.

Vendimet e Kongresit VII të Kominternit shënonin një etapë të re në zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare. Zbatimi i tyre krijues në kushtet konkrete të çdo vendi u hapte komunistëve rrugën për t'u vënë në krye të masave të gjera popullore dhe për t'u bërë forca kryesore drejtuese e lëvizjes punëtore, demokratike e antiimperialiste.

Këto vendime kishin një rëndësi të madhe për të gjitha vendet, në mënyrë të veçantë për ato vende, si Shqipëria, që kërcënoheshin drejtpërdrejt nga fashizmi.

## **Komunistët në krye të lëvizjes revolucionare në rritje**

italo-shqiptare të marsit 1936, të cilat shënonin një hap të madh drejt nënshtrimit të plotë të vendit ndaj Italisë fashiste.

Në këto kushte në Shqipëri, krahas luftës kundër shfrytëzimit kapitalist dhe regjimit zogist, po merrte një rëndësi gjithnjë më të madhe lufta kundër skllavëruesve fashistë. Borgjezia shqiptare ishte lidhur ngushtë me regjimin zogist dhe nuk mund të udhëhiqte luftën për ruajtjen e lirisë dhe të pavarësisë së vendit. Edhe ato forca demokratike borgjeze që e vazhduan luftën kundër regjimit zogist e kundër nënshtrimit ndaj Italisë, pas dështimit të kryengritjes së Fierit, nuk ishin më të afta të drejtonin lëvizjen antizogiste dhe antifashiste për shkak të mungesës së vendosmërisë dhe të organizimit të tyre.

E vetmja forcë revolucionare në luftën për të siguruar të drejtat demokratike dhe për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e atdheut ishin tani komunistët, të cilët u vunë në krye jo vetëm të lëvizjes punëtore, por edhe të lëvizjes popullore antizogiste dhe antifashiste.

Kryengritja e Fierit e kishte tronditur regjimin zogist dhe kishte diskredituar politikën e tij. Mbreti u detyrua, siç shkruante Ali Kelmendi, «të fillojë një manovër demagogjike me qëllim që të fitojë kohë, të marrë frymë pas goditjes që hëngri dhe të përgatisë një sulm të dytë kundër popullit». Në tetor 1935 ai solli në fuqi një qeveri të re «liberale», e cila bëri premtime të bujshme për reforma.

Liritë e shpallura, ndonëse shumë të kufizuara, u shfrytëzuan nga komunistët për të ndërmarrë hapa të reja për organizimin e mëtejshëm të klasës punëtore dhe për shtrirjen e ndikimit të tyre në masat e gjera të popullit.

Në vjeshtë të vitit 1935 filloi të lëvizë qendra më e rëndësishme punëtore e vendit, Kuçova (sot Qyteti Stalin) që administrohej nga Shoqëria italiane e vajgurit (AIPA). Për nxjerrjen e naftës dhe në sektorët ndihmës punonin rreth 1600 punëtorë shqiptarë. Qysh nga mesi i vitit 1934 në Kuçovë ishte formuar me iniciativën e komunistëve një bërthamë ilegale për organizimin sindikal të punëtorëve të naftës. Në tetor 1935 ajo formoi shoqërinë «Puna», e cila u njoh nga qe-

Presioni i Italisë fashiste mbi Shqipërinë dhe gjunjëzimi i Zogut shpunë në përfundimin e marrëveshjeve

veria. Edhe pse në statut, për t'iu shmangur pengesave nga ana e qeverisë, thuhej se «Puna» krijohej për «mbrojtjen e dinjitetit, mbrojtjen e interesave dhe ndihmën morale e materiale të anëtarëve të saj», ajo u kthye menjëherë në një organizatë punëtore revolucionare antizogiste dhe antifashiste. Brenda një viti ajo numëronte më se 1500 anëtarë.

Shoqëria «Puna» e Kuçovës i paraqiti qeverisë e parlamentit një peticion, ku kërkohet vendosja e 8-orëshit, marrja e masave për përmirësimin e kushteve të fjetjes, të ushqimit e të higjienës, si edhe të disa masave të sigurimit shoqëror. Kërkoi gjithashtu të mos detyroheshin punëtorët nga pronarët e huaj të përshëndetnin në mënyrë fashiste. Kur përfaqësuesi i qeverisë, që u dërgua në Kuçovë, i hodhi poshtë kërkesat e punëtorëve, këta protestuan me një grevë të shkurtër dhe me një demonstratë kundër tij. E mbështetur nga qeveria, AIPA pushoi nga puna drejtuesit dhe aktivistë të tjerë të shoqërisë. Me qëllim të hapur antishqiptar ajo e shpalli ditë pune 28 Nëntorin 1935, festën e Pavarësisë. Këtë ditë shoqëria «Puna» organizoi një manifestim të fuqishëm që drejtohej kryesisht kundër fashistëve italianë.

Në janar të vitit 1936 ajo vendosi të plotësonte kërkesat e saj me anë të grevës, e cila më 11 shkurt mori karakter të përgjithshëm. Për të shtypur grevën qeveria dërgoi forca të mëdha xhandarësh, të kryesuara nga vetë ministri i Brendshëm. Këto forca arrestuan 60 nga punëtorët më të përparuar dhe larguan nga Kuçova në qytete të ndryshme 300 të tjerë. Shoqëria «Puna» praktikisht pushoi së qeni.

Greva e përgjithshme, megjithëse dështoi, pati rëndësi të madhe. Ajo ishte për punëtorët një shkollë revolucionare. Nga ana tjetër, ajo e detyroi qeverinë t'u kërkonte sipërmarrësve, ndonëse formalisht, të krijonin kushte më të përshtatshme pune.

Krahas lëvizjes greviste, një lëvizje e fuqishme popullore kundër zisë së bukës dhe regjimit zogist po përhapej në krahinat e tjera të vendit. Në vjeshtën e vitit 1935 zia kishte arritur kulmin. Mijëra njerëz i kërcënonte vdekja nga uria. Ushtria e të papunëve ishte shtuar shumë. Pakënaqësia dhe zemërimi përfshinë shtresa të ndryshme shoqërore, veçanërisht masat e varfra të qytetit e të fshatit.

Një rol aktiv në lëvizje luanin zejtarët që po shkatërrheshin nga konkurrenca e prodhimit industrial. Lufta e tyre ushqehet nga iluzione mikroborgjeze për ta ruajtur prodhi-



min e vogël dhe për të ndaluar prodhimin e fabrikave. Ndonëse këto kërkesa ishin utopike, lufta drejtohej në thelb kundër mjerimit që kishte mbuluar vendin.

Grupi Komunist i Korçës diti të përfitojë nga gjendja e krijuar, të vihet në krye të masave popullore dhe t'i japë luftës së tyre karakter politik. Fraksionet komuniste të shoqërisë së punëtorëve të ndërtimit «Puna», të shoqërisë së këpuçarëve, të rrobaqepësve, të «Lidhjes së Nëpunësve Privatë», organizatë e re sindikale që u formua në dhjetor 1935, etj. filluan të vepronin gjallërisht për të organizuar lëvizjen, për ta bërë atë më masive e më kompakte dhe për ta drejtuar kundër regjimit zogist. Më 21 shkurt 1936 shpërtheu demonstrata e madhe antizogiste e Korçës që ka hyrë në histori me emrin «demonstrata e bukës». Përleshja e përgjakshme me forcat e xhandarmërisë nuk i pengoi punëtorët e zejtarët, me të cilët u bashkuan edhe nxënësit e shkollave të mesme, të bënin një demonstratë të re pasdite. Ndeshja me xhandarët mori karakter akoma më të ashpër.

Demonstrata e bukës në Korçë ishte një aksion i madh popullor antizogist i organizuar dhe i udhëhequr nga komunistët. Ajo pati jehonë të gjerë në gjithë vendin. Shkaktoi panik në autoritetet e klasat sunduese dhe frymëzoi me shebullin e saj masat popullore të krahinave të tjera. Manifestime kundër zisë së bukës u bënë edhe në Gjirokastrë, Sarandë, Leskovik, Bilisht, Pogradec e Berat. Demonstrata të tjera popullore antizogiste u zhvilluan në Vlorë dhe në Elbasan.

Në shtator 1936 Ali Kelmendi u dëbua prej atdheut nga qeveria zogiste. Përpara se të largohej ai u takua në Gjirokastrë me Enver Hoxhën, i cili porsa ishte kthyer në Shqipëri dhe dallohej si militant komunist aktiv.

### **Shtypi i drejtuar nga komunistët**

Ngjarjet e vitit 1936 dëshmonin për shtimin e ndikimit të komunistëve në masat, por në plan kombëtar arritjet ishin ende shumë të kufizuara. Për zgjerimin e ndikimit të tyre një rol të veçantë duhej të luante shtypi. Por censura e rreptë zogiste nuk i lejonte të shprehnin hapur pikëpamjet e tyre me anë të këtij mjeti. Shkrimet me frymë përparimtare që ata arrinin të botonin në organet e shtypit borgjez ishin të pakta.

«Liria kombëtare» dhe dy broshura të fraksionit komunist të Komitetit të Çlirimit Nacional, të botuara më 1934 e 1935, ku jepej një program revolucionar për përmbysjen e regjimit zogist e për vendosjen e republikës popullore, si edhe gazetatat «Populli» e «Sazani», organe të grupit të komunistëve shqiptarë të Lionit (Francë), përhapeshin shumë pak në Shqipëri, kryesisht në një rreth të kufizuar intelektualësh.

Nevoja për të zhvilluar gjerësisht brenda vendit idetë demokratike, antifeudale dhe antiimperialiste e kishte bërë të domosdoshme përdorimin nga ana e komunistëve të formave të reja të punës. Komunistët kishin filluar të shfrytëzonin me sukses shoqëritë kulturoro-artistike. Shoqëria «Besa shqiptare», e krijuar qysh më 1929 nga nxënësit e gjimnazit të Shkodrës, dhe grupi teatral i shoqërisë «Puna» të Korçës fituan popullaritet me shfaqjet teatrale me frymë patriotike e përparimtare. Ndërkohë, organizatat komuniste të Tiranës dhe të Korçës shfrytëzuan menjëherë rrethanat e krijuara pas ardhjes në fuqi të qeverisë «liberale» për botimin e organeve të tilla që gjetën një përhapje të gjerë në gjithë vendin.

Më i rëndësishmi ndër këto organe ishte «Bota e re» që filloi të botohej në Korçë prej prillit 1936. Ndonëse në shkrimet e botuara përdorej, për shkak të censurës, gjuha e Ezopit, ajo shërbeu si një armë e fuqishme e kritikës kundër regjimit në fuqi dhe plagëve të shoqërisë shqiptare. Ajo zhvilloi një luftë të ashpër kundër ideologjisë reaksionare fashiste dhe trajtoi në frymë demokratike revolucionare problemet themelore shoqërore e politike që qëndronin përpara popullit, duke ftuar opinionin demokratik shqiptar të luftonte për zgjidhjen e tyre. «Bota e re» u bë organi më i dashur i punëtorëve e zëhtarëve përparimtarë, i të rinjve dhe i intelektualëve demokratë.

### **Shtirirja e organizatave komuniste. Grupi Komunist i Shkodrës**

Ngjarjet revolucionare të viteve 1935-1936 ishin një sukses i rëndësishëm i lëvizjes komuniste. Por ato kishin nxjerrë njëkohësisht në shesh një varg dobësish në organizimin e lëvizjes punëtore dhe antizogiste. Detyra e parë që dilte në këto rrethana ishte shtirirja e lëvizjes komuniste në të gjithë vendin. vendosja e lidhjeve më të shëndosha midis organizatave dhe bashkërendimi i veprimtarisë së tyre.

Me këtë qëllim Grupi Komunist i Korçës krijoi në dhjetor 1936 një komitet të ri drejtues, që u ngarkua të zhvillonte veprimtari në të gjitha qarqet e vendit. Ky komitet kishte si synim të kthehej në një qendër drejtuese të lëvizjes komuniste shqiptare. Por ai nuk ia arriti dot këtij synimi. Organizata të reja të Grupit të Korçës u krijuan vetëm në Berat e në Tiranë, ku u formua edhe shoqëria e punëtorëve tipografë. Puna e kryer prej tij në qarqet e ndryshme të vendit kishte karakter të sipërfaqshëm dhe zhvillohej me hope. Rekrutimi i elementëve të rinj nuk bëhej mbi bazën e një njohjeje të thellë të tyre. Kjo ishte arsyeja që në radhët e organizatës hynë elementë antimarksistë që e dëmtuan lëvizjen komuniste.

Në këtë kohë një vatër e re e rëndësishme e lëvizjes komuniste shqiptare po krijohej në Shkodër. Organizata e parë komuniste, e themeluar aty qysh në vitin 1934, e kishte zgjeruar veprimtarinë e vet. U krijuan celula të reja dhe grupe simpatizantësh. **Grupi Komunist i Shkodrës** u shtri në Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë, Korçë etj. Për drejtimin e organizatave më 1937 u krijuan komitete qarkore në Shkodër dhe në Tiranë. Kryetar i grupit ishte Zef Mala, intelektual me pikëpamje teorike të shtrembra dhe me një paqartësi të theksuar politike.

— Veprimtaria e grupit në masat ishte e kufizuar në rrethet shkollore, zejtare dhe në disa qendra punëtore. Arritje të rëndësishme të tij ishin krijimi i organizatës së rinisë në Shkodër e në Tiranë dhe formimi i shoqërisë së punëtorëve marangozë në Tiranë.

— Grupi i Shkodrës nuk kishte një vijë të qartë e të prerë politike, një formë të caktuar organizative, një disiplinë e një konspiracion të shëndoshë në radhët e tij. Celulat, që përbëheshin përgjithësisht prej tre anëtarësh, merreshin kryesisht me përgatitjen e tyre teorike. Letërsia që përdorej për këtë qëllim dhe që përfshinte një varg veprash të klasikëve të marksizëm-leninizmit shërbeu për përhapjen e ideve komuniste. Por, ashtu si edhe në grupet e tjera, në organizatat e Grupit të Shkodrës qarkullonte edhe letërsi trockiste dhe anarkiste.

Në rrugën e vet të zhvillimit lëvizjes komuniste shqiptare i dolën pengesa serioze të shkaktuara nga trockistët. Në fillim të vitit 1937 kishte ardhur nga Athina në Shqipëri

Andrea Zisi (me pseudonimin «Zjarri»), i cili pretendonte se ishte kryetar i së ashtuquajturës «parti komuniste shqiptare», të formuar në Greqi dhe të njohur gjoja nga Kominterni! Në të vërtetë ai ishte udhëheqësi i një grupi trockist të krijuar në Athinë më 1936 që njihet me emrin Grupi i «Zjarrit». A. Zisi i kishte vënë vetes detyrë të shkrinte grupet komuniste shqiptare në «partinë» e vet dhe t'i detyronte ato të pranonin vijën e tij antimarksiste. Grupi i Korçës nuk e njohu «partinë» e «Zjarrit» dhe u shpreh i gatshëm të bashkëpunonte me të vetëm në rast se ai pranonte platformën e këtij Grupi. Ndërkaq A. Zisi vendosi lidhje me fraksionistin N. Xoxi, me të cilin gjeti një gjuhë të përbashkët. Të dy bashkërenduan luftën kundër Grupit Komunist të Korçës.

Një punë armiqësore kundër lëvizjes komuniste kishte filluar të zhvillonte nga ana e tij Aristidh Qendroja në Tiranë. Ai formalisht bënte pjesë në Grupin e Korçës. Mungesa e kontrollit nga udhëheqja e Grupit i kishte dhënë mundësi atij të vepronte pa u demaskuar. Ai kishte rekrutuar në Tiranë në emër të grupit një numër anëtarësh, të cilët i edukonte me pikëpamjet e veta antimarksiste. Më 1937 këta kishin degjeneruar plotësisht në një grup trockistësh.

Në këtë kohë Grupi Komunist i Shkodrës bëri përpjekjen e parë për t'u lidhur me Grupin e Korçës. Në letrën që u dërgoi komunistëve të Korçës më 1937 ai kërkonte që këta, si më me përvojë, t'i jepnin ndihmë për çështjet e organizimit. Gatishmëria që tregoi Grupi i Korçës për të ndihmuar u sabotua nga N. Xoxi. Duke u paraqitur si përfaqësues i Grupit Komunist të Korçës, ai kishte njoftuar Grupin e Shkodrës mbi krijimin e «partisë komuniste shqiptare» në Greqi dhe mbi ardhjen së shpejti të «komitetit qendror» të saj në Shqipëri. N. Xoxi i akuzoi udhëheqësit e Grupit të Korçës dhe Ali Kelmendin si nacionalistë e përçarës të lëvizjes komuniste. Pikëpamjet e tij gjetën një truall të përshtatshëm të krerët e Grupit të Shkodrës, ndër të cilët mbizotëronte paqartësia ideologjike. Zef Mala e Niko Xoxi u bënë në fakt drejtuesit kryesorë të grupit. Afrimi dhe bashkëpunimi midis dy grupeve kryesore komuniste u minua.

Përçarja i sillte një dëm të madh lëvizjes komuniste dhe, si rrjedhim, gjithë lëvizjes demokratike revolucionare. Në këtë gjendje e gjeti atë fushata e tërbuar antikomuniste që shpërtheu pas ardhjes në fuqi të qeverisë së re reaksionare në nën-

tor 1936. Kjo qeveri organizoi ndjekje të ashpra kundër komunistëve dhe gjithë elementëve përparimtarë. Ajo shpërnda shoqëritë punëtore, ndaloi formimin e shoqërive të reja dhe lejoi vetëm krijimin e korporatave punëtore të tipit fashist nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të autoriteteve qeveritare. U ndalua shtypi përparimtar, kurse mbi të gjitha librat dhe organet e shtypit që botoheshin brenda vendit ose vinin nga jashtë u vendos një censurë e rreptë. Më 1937 Zogu arrestoi pjesën më të madhe të oficerëve komunistë.

Qeveria zogiste, nga ana tjetër, kishte lejuar gjerësisht përhapjen e fashizmit në Shqipëri. Të dërguar të posaçëm të Musolinit iu përveshën punës për organizimin e rinisë shqiptare sipas modelit fashist. Ata krijuan në Korçë «komitetin e veprimit» me elementë fashistë shqiptarë dhe një rrjet të gjerë agjentësh në mbarë vendin, që kishin detyrë të përgatishnin fushën për skllavërimin e plotë të vendit nga Italia. Për arritjen e këtij qëllimi një mision të posaçëm kryente kleri reaksionar katolik.

Zogu përkrahu pa rezerva krengritjen kundërrevolucionare që kishte shpërthyer më 1936 në Spanjë dhe e njohu qeverinë fashiste të Frankos.

Politika thellësisht reaksionare profashiste e Zogut ngjalli ndër komunistët dhe patriotët shqiptarë një shqetësim të madh për fatet e pavarësisë së vendit. Ata po e kuptonin gjithnjë e më mirë rrezikun që paraqiste fashizmi për Shqipërinë dhe për tërë popujt. Për këtë kishin ndihmuar drejtpërdrejt edhe vendimet e Kongresit VII të Kominternit. Luftën e drejtë të popullit spanjoll komunistët shqiptarë e shikonin si një luftë edhe për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë. Urrejtja kundër fashizmit dhe internacionalizmi proletar i komunistëve dhe i antifashistëve shqiptarë u shpreh me një forcë të veçantë në gatishmërinë e tyre për të shkuar vullnetarë në Spanjë. Grupet komuniste qysh nga viti 1936 dërguan atje anëtarë të vet për të luftuar përkrah popullit spanjoll. Vullnetarët shqiptarë, midis të cilëve Mehmet Shehu, Asim Vokshi, Thimjo Gogozoto, Ramiz Varvarica, Zef Hoti, Musa Fratari etj., luftuan trimërisht kundër fashizmit në radhët e brigadave ndërkombëtare. Shumë prej tyre ranë dëshmorë në fushën e betejës, ndërsa Teni Konomi, anëtar i udhëheqjes së Grupit Komunist të Korçës, u vra nga fashistët para se të arrinte në tokën spanjolle.

## Vija e re e lëvizjes komuniste shqiptare

vetëm bashkëpunimi i ngushtë midis grupeve komuniste, por edhe riorganizimi i gjithë punës së tyre në frymën e vendimeve të Kongresit VII të Internacionales Komuniste.

Përpjekjet e para për të zbatuar vijën e re të Kominternit u bënë nga komunistët shqiptarë jashtë atdheut. Me iniciativën e fraksionit komunist të Komitetit të Çlirimit Nacional, që ndodhej në Paris, u krijua në mars 1936 «Fronti Demokratik» i organizatave politike shqiptare në mërgim. Por pjesa konservatore e borgjezisë antizogiste në mërgim, e përfaqësuar në këtë front nga «Bashkimi Kombëtar», kishte degjeneruar politikisht dhe nuk ishte e aftë të kryente veprime patriotike e revolucionare. Si pasojë «Fronti Demokratik» u shpërnda brenda një kohe të shkurtër.

Grupet komuniste brenda vendit nuk kishin vendosur ende lidhje të rregullta me Kominternin, për arsye se mungonte partia e njohur zyrtarisht si seksion i tij. Megjithatë, Kominterni ishte informuar herë pas here nga Ali Kelmendi dhe komunistët shqiptarë të Francës mbi veprimtarinë e grupeve komuniste në Shqipëri.

Në dhjetor 1936 Ali Kelmendi mbajti raportin në mbledhjen me aktivistët komunistë shqiptarë që vepronin jashtë shtetit. Kjo mbledhje u organizua në Moskë me iniciativën e Seksionit Ballkanik të Kominternit për të analizuar gjendjen e lëvizjes komuniste shqiptare dhe për të caktuar detyrat që dilnin para saj në dritën e direktivave të Kongresit VII të Kominternit. Ali Kelmendi kërkonte të forcohej puna për organizimin dhe krijimin e një partie komuniste. Për këtë qëllim duhej të krijohesh një qendër organizative në Shqipëri, e cila do të mbështetej në grupet komuniste brenda vendit, në radhë të parë, në Grupin e Korçës. Kjo qendër do të kishte detyrë «forcimin dhe udhëheqjen e grupeve komuniste ekzistuese, organizimin e lëvizjes komuniste në gjithë Shqipërinë si edhe thirrjen e një kongresi kushtetues të partisë komuniste të Shqipërisë»<sup>1</sup>. Me iniciativën dhe nën udhëheqjen e

---

1 A. Kelmendi. Raport dërguar Kominternit, 14 dhjetor 1936, AQP.

komunistëve duhej të krijohesh një organizatë ilegale dhe e centralizuar me karakter demokratik e antifashist për të luftuar kundër regjimit zogist dhe imperializmit italian, për një republikë demokratike dhe për prishjen e marrëveshjeve skllavëruese me Italinë fashiste. Mbi bazën e kësaj organizate do të krijohesh fronti popullor.

Pas shqyrtimit të raportit, mbledhja mori vendime që u miratuan edhe nga Kominterni. Sipas këtyre vendimeve, në Shqipëri do të krijohesh një organizatë ilegale me karakter demokratik dhe antifashist. Ajo do të drejtohej nga një Komitet Qendror, ku do të bënin pjesë komunistë dhe nacionalistë patriotë. Bërthama komuniste e këtij komiteti do të përbëhej prej pesë vetash që do të punonin brenda në vend. Kjo organizatë do të shërbente si mbështetje për krijimin e frontit popullor. Kominterni vërente se celulat e vjetra ishin të shkëputura nga masat e të mbyllura në vetvete dhe, si të tilla, nuk ishin të afta të zbatonin vijën e re. Prandaj, ato dhe forumet e tyre drejtuese duhej përkohësisht të shpërndaheshin e të riorganizoheshin mbi bazën e partisë, pasi të ishin hedhur themele të shëndosha në masat me anë të veprimtarisë në shoqëritë legale. Lidhjet midis komunistëve duhej të ishin individuale. Detyrën e qendrës organizuese komuniste deri në formimin e partisë do ta kryente bërthama komuniste e Komitetit Qendror. Programi minimum i komunistëve, që do të ishte dhe platforma politike e organizatës së re, përmblihte dy detyra kryesore: a) luftën për mbrojtjen e të drejtave kombëtare dhe b) luftën për mbrojtjen e të drejtave demokratike. Për mbrojtjen e pavarësisë kombëtare, organizata e re do të bashkëpunonte me të gjitha klasat, shtresat shoqërore dhe elementët që ishin për luftën kundër skllavërimit fashist. Propagandimi i vijës së re do të bëhej me anën e një organi ilegal që do të botohej nga komunistët.

Për t'i çuar në Shqipëri këto udhëzime u ngarkuan Ali Kelmendi e Koço Tashkoja. Ali Kelmendi shkoi në Francë për të rregulluar lejen e hyrjes në atdhe. Atij iu desh të zhvillonte aty një veprimtari të gjerë për zbatimin e vijës së re në radhët e komunistëve dhe të mërguarve shqiptarë. Një rëndësi të veçantë i kushtoi ai demaskimit të veprimtarisë armiqësore të anëtarit të fraksionit komunist të Komitetit të Çlirimit Nacional, Llazar Fundos, i cili përpiqej të shkatërronte gjithë punën e bërë nga komunistët shqiptarë në Francë. Lla-

zar Fundoja sabotonte dërgimin e vullnetarëve shqiptarë në Spanjë për të luftuar kundër fashizmit dhe, më në fund, doli hapur kundër komunizmit, duke marrë në mbrojtje buharinistët, trockistët dhe armiqtë e tjerë të dënuar nga Partia Komuniste (Bolshevike) e Bashkimit Sovjetik. Ai u dënua si renegat i komunizmit, si provokator dhe agjent i imperializmit dhe u përjashtua nga radhët e lëvizjes komuniste shqiptare.

Sëmundja nuk e lejoi Ali Kelmendin të kthehej në atdhe për të kryer misionin që i ishte ngarkuar. Ai vdiq në Paris më 11 shkurt 1939.

### **Përpjekjet për zbatimin e vijës së re në Shqipëri**

Grupi i Korçës u njoh i pari me udhëzimet e reja të Kominternit në vjeshtë të vitit

1937. Udhëheqësit e Grupit, pasi e studiuuan vijën e re, e pranuan atë si platformë për veprimtarinë e mëtejshme të tyre, megjithëse e pritën me rezerva udhëzimin për shpërndarjen e celulave komuniste e të komiteteve dhe në fillim ngurruan ta zbatonin. Grupi caktoi përfaqësuesin e vet në bërthamën komuniste të Komitetit Qendror. Ai vendosi t'i vinte në jetë udhëzimet e reja, duke zgjeruar punën me masat në organizatat legale, si shoqëritë e zejtarëve, këshillat e lagjeve, këshilli i bashkisë, këshilli i dhomës së tregtisë, grupet paraushtarake, shoqatat e rinisë jashtëshkollore, si dhe nëpërmjet shtypit legal etj.

Përhapja e vijës së re në organizatat e tjera komuniste të vendit ndeshi qysh në fillim në kundërshtimin e krerëve të Grupit të Shkodrës. Zef Mala dhe Niko Xoxi nuk e pranuan vijën e re duke thënë se ishin në parim për revolucionin shoqëror dhe jo kombëtar, se ishin kundër imperializmit, por nuk donin të punonin me nacionalistët, se ishin për aksione të drejtpërdrejta, kur të vinte koha dhe jo për aksione të ngadalshme e të tërthorta etj!

Vijën e re e kundërshtoi edhe organizata trockiste e Tiranës e udhëhequr nga Aristidh Qendroja, i cili, ashtu si Zef Mala, bashkëpunimin me nacionalistët patriotë dhe krijimin e frontit popullor i quante tradhti ndaj klasës punëtore.

Për sqarimin politik dhe ideologjik të komunistëve, për demaskimin e trockistëve dhe për bashkimin e forcave të shëndosha komuniste në një parti të vetme komuniste shqiptare, kërkohet një punë e vendosur e këmbëngulëse. Por ata



që ia vunë vetes këtë detyrë u tërhoqën përpara vështirësive. Bërthama komuniste në Komitetin Qendror të organizatës së re që do të formohej nuk veproi asnjëherë si e tillë. Anëtarët e saj nuk ishin njerëz të sakrificës. Vetë Koço Tashkoja, që kishte sjellë direktivat e reja dhe ishte përgjegjësi kryesor për zbatimin e tyre, u tregua krejt i paaftë nga pikëpamja politike dhe organizative për vënien e tyre në jetë.

Grupi i Korçës, nga ana e tij, vazhdoi të mbetej i mbyllur në qytetin e vet. Në mars të vitit 1938 ai i shpërndau celulat. Kjo solli një farë hutimi e shthurjeje në radhët e komunistëve, të cilët e shikonin celulën si formën më të përshtatshme për t'u edukuar me ideologjinë marksiste dhe për të shqyrtuar kolegjalisht çështjet e lëvizjes punëtore. Megjithatë, si para shpërndarjes së celulave, ashtu edhe më pas, komunistët e Grupit luftuan për zbatimin e vijës së re në Korçë dhe arritën suksese të rëndësishme. Ata u vunë në krye të lëvizjes demokratike të qytetit dhe e zgjeruan ndikimin e tyre në masat popullore që shikonin te komunistët mbrojtësit më të vendosur të interesave të popullit. Kjo u duk në zgjedhjet e këshillave të lagjeve e të këshillit të dhomës së tregtisë, si domos në punën me rininë dhe në zgjedhjet bashkiake. Grupi e zgjeroi dhe e thelloi shumë ndikimin e vet në rininë punëtore, zejtare e shkollore dhe u bë udhëheqës i organizatës jashtëshkollore «Rinia Korçare», duke shkatërruar çdo përpjekje të qeverisë zogiste e të agjentëve fashistë për t'i dhënë asaj organizate orientim kundërrevolucionar. Për zgjedhjen e këshillit të ri të bashkisë në qershor 1938, komunistët paraqitën listën e kandidatëve të bllokut demokratik, ku bënin pjesë, krahas tyre, edhe elementë borgjezë përparimtarë. Në këto zgjedhje ata korrën një fitore të shkëlqyer. Lista e bllokut demokratik mori 86 për qind të votave kundrejt listës, prapa së cilës qëndronte grupi kapitalist «Shoqëria Gjenerale e Elektrikut», megjithëse kjo e fundit harxhoi për zgjedhjet shuma të mëdha të hollash dhe u përkrah fuqimisht nga organet shtetërore. Komunistët me punën e tyre i shkundën masat e zgjedhësve nga plogështia dhe indiferentizmi politik i deriatëhershëm dhe i bënë të merrnin pjesë gjallërisht në jetën politike. Këshilli i ri bashkiak i Korçës, i udhëhequr nga komunistët, mori një varg masash me karakter demokratik që s'ishin parë në praktikën e këshillave bashkiake të vendit. Ai i bënte mbledhjet hapur për t'u dhënë mundësi

zgjedhësve të kontrollonin veprimtarinë e tij, spastroi aparatit administrativ të bashkisë nga nëpunësit reaksionarë dhe i zëvendësoi me komunistë e demokratë. Një pjesë të fondeve të bashkisë i përdori për të ndihmuar financiarisht të vobektit dhe për të ndërtuar rrugë, ujësjellës etj. në lagjet e varfra të qytetit. Ai hodhi në gjuq «Shoqërinë Gjenerale të Elektrikut» me qëllim që të anulonte koncesionin e elektrikut të marrë prej saj me anë rryshfetesh etj.

Edhe lista e bllokut demokratik që paraqiti dega e Grupit Komunist të Korçës në Durrës fitoi në zgjedhjet bashkiake që u zhvilluan në korrik të këtij viti në atë qytet. Një sukses të tillë korrën edhe listat demokratike në Gjirokastrë e në Peqin.

### **Ashpërsimi i mosmarrëveshjeve midis Grupit të Korçës dhe të Shkodrës**

Një rëndësi të veçantë Grupi i Korçës i kushtoi luftës kundër fashizmit që po kërcënonte lirinë dhe pavarësinë e vendit. Kjo luftë përbënte një detyrë themelore strategjike të komunistëve. Organi ilegal «Përpara» që grupi nisi të botonte në vjeshtë të vitit 1937 me qëllim që të edukonte anëtarët e vet dhe të propagandonte vijën e re, e demaskonte fashizmin si regjim të shfrytëzimit, të shtypjes dhe të luftës, tregonte fytyrën e vërtetë prej armiqsh të popullit të iniciatorëve të lëvizjes fashiste në Shqipëri dhe të mbrojtësve të tyre — çifligarëve, tregtarëve të mëdhenj dhe fajdexhinjve. Revista i paralajmëronte komunistët për rrezikun fashist që i kanosej vendit dhe u bënte thirrje të mobilizonin popullin në luftë kundër tij. Grupi Komunist i Korçës nuk u kufizua vetëm me propagandën për të krijuar një lëvizje të gjerë antifashiste, por kaloi edhe në veprime të drejtpërdrejta. Më 1938 komunistët u përleshën në rrugët e qytetit të Korçës me anëtarë të «Komitetit Fashist» që vepronte në Shqipëri. Ata bënë të dështonte orvatja për të organizuar rininë sipas sistemit fashist italian.

Ndaj problemeve të brendshme të vendit Grupi i Korçës ndoqi një vijë përgjithësisht të drejtë. Duke u mbështetur në vendimet e Kongresit VII të Kominternit, ai e argumentonte teorikisht në faqet e revistës «Përpara» nevojën e lidhjeve të ngushta të komunistëve me masat e gjera popullore, të udhë-

heqjes së këtyre masave nga komunistët në luftën e përditshme për plotësimin e kërkesave më elementare politike dhe ekonomike dhe të krijimit të një fronti popullor që do të mobilizonte masat në luftën kundër rrezikut fashist. Mbi këtë bazë Grupi i Korçës paraqiti edhe programin minimum, i cili parashikonte luftën a) për të drejtat kombëtare të popullit kundër imperializmit; b) për të drejtat demokratike të popullit kundër shkëlqes së statutit kombëtar dhe orvatjeve për të mbjellë fashizmin në Shqipëri; c) për paqen kundër luftës dhe ç) për të drejtat elementare ekonomike të popullit.

«Përpara» vinte në dukje se në një vend gjysmëkolonial si Shqipëria nuk kishte vetëm një problem shoqëror, por edhe një problem kombëtar, se ky problem i fundit dilte në plan të parë dhe se lëvizja kombëtare, për të cilën ishin të interesuara masat e gjera popullore, duhej të lidhej ngushtë me lëvizjen shoqërore të klasës punëtore. Kjo klasë ishte e vetmja në gjendje t'i udhëhiqte masat e të mbronte besnikërisht interesat e tyre, por të kufizoheshë në klasën punëtore, të luftoje vetëm me forcat e saj, pa mobilizuar forcat kombëtare ishte një aventurë e rrezikshme. «Detyrohemi të punojmë kudo që grumbullohen njerëz, në organizatat e shtetit, shkollat, klubet, organizatat fetare, të grave e gjetkë... Programi dhe taktika jonë legale lehtëson punimin në organizatat legale, të lejuara ose të krijuara nga shteti. Detyrohemi të veprojmë tërthori vetëm e vetëm se duam të mbledhim fuqi të veprojmë drejtpërdrejt. Fuqia është populli; pa turmat popullore s'jemi veç një grusht njerëzish...»<sup>1</sup>

Zbatimi i kësaj vije i solli Grupit Komunist të Korçës një varg suksesesh, por vetëm brenda në qytet. Grupi e kuptonte shumë ngushtë bazën mbi të cilën duhej të formohej fronti popullor në një vend të prapambetur agrar, siç ishte Shqipëria, ku fshatarësia përbënte shumicën dërrmuese të popullsisë. Në një kohë kur predikonte se nga klasa punëtore duhej kaluar te shtresat e tjera të popullit, ai nuk bëri pothuajse asgjë për fshatin, për aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, pa të cilën nuk mund të krijoheshë fronti popullor.

---

<sup>1</sup> Lëvizja nacionale dhe lëvizja sociale, «Përpara», shtator 1938. AQP.

Grupi i Shkodrës, nga ana e tij, nuk kishte nxjerrë mësimet e duhura nga arritjet e komunistëve në veprimtarinë demokratike dhe antifashiste në Korçë e gjetkë. Udhëheqësit kryesorë të këtij Grupi, në vend që të luftonin për bashkimin e komunistëve të vendit dhe për zgjerimin e lidhjeve të tyre me masat e gjera popullore, ndoqën rrugën e përçarjes e të luftës kundër Grupit që kishte pranuar vijën e re. Një rol negativ në këtë luftë luajti sidomos dalja në gjysmën e dytë të vitit 1938 e «Buletinit jeshil», organ ilegal i Grupit të Shkodrës.

Në këtë buletin u botuan pjesë nga veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, materiale që flisnin për arritjet në ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, për epërsinë e sistemit socialist mbi atë kapitalist, shkrime që demaskonin regjimin zogist, fashizmin dhe politikën skllavëruese të Italisë në Shqipëri etj. Këto shkrime ishin një kontribut i rëndësishëm për lëvizjen komuniste shqiptare. Por, nga ana tjetër, Grupi Komunist i Shkodrës me anën e «Buletinit jeshil» u përpoq të argumentonte teorikisht vijën e gabuar të ndjekur prej tij, duke mbajtur ndaj problemit themelor të krijimit të frontit popullor antifashist një qëndrim antimarksist, të imponuar nga Zef Mala e Niko Xoxi.

Pikëpamjet antimarksiste të udhëheqësve të Grupit të Shkodrës e kishin burimin në kuptimin e vlerësimin e shtrembër të rolit të klasave e të shtresave shoqërore në lëvizjen revolucionare shqiptare dhe të gjendjes së krijuar në Shqipëri si pasojë e politikës skllavëruese të fashizmit italian. Ata thoshin se në Shqipëri nuk kishte proletariat e borgjezi në kuptimin e vërtetë të fjalës, se pjesa më revolucionare e popullsisë ishin zejtarët dhe se fshatarësia do të ishte aleatja e proletariatit, kur ky, me zhvillimin e mëtejshëm kapitalist të vendit, do të bëhej i aftë të merrte në dorë flamurin e revolucionit socialist. Meqë nuk kishte proletariat e borgjezi, nuk zhvillohej as luftë e vërtetë klasore dhe, rrjedhimisht, nuk ishin krijuar ende kushtet për revolucion! Edhe lëvizja komuniste kishte lindur në Shqipëri jo si një nevojë e domosdoshme e klasës punëtore për të luftuar kundër kapitalistëve, por si rezultat i ndikimit të jashtëm! Në këto rrethana, përderisa kjo lëvizje kishte lindur, detyra e komunistëve ishte të edukonin e të përgatisnin kuadrot që nesër do të fillonin agjitacionin

e gjerë në masat popullore, do të tërhiqnin pas vetes proletariatin dhe do të merrnin në dorë drejtimin e revolucionit komunist! Me të tillë kadro, të edukuar e të përgatitur teorisht, ata kërkonin të formonin partinë komuniste shqiptare.

Udhëheqësit e Grupit të Shkodrës nuk i kuptonin ndryshimet politike që kishin ndodhur në Shqipëri e në botë për të përpunuar, në përputhje me këto kushte, një vijë të drejtë revolucionare. Ata e hodhën poshtë direktivën e Kominternit për të krijuar frontin popullor, duke e përligjur këtë me faktin se Shqipëria ishte një vend gjysmëkolonial, pa klasa të diferencuara, pa proletariatin, pa parti komuniste, pa parti të tjera politike, me një padituri të përgjithshme etj. Udhëheqësit e Grupit të Shkodrës nuk ishin kundër vendosjes së një rendi demokratik, antiimperialist e antifashist, por forcat kryesore ata kërkonin t'i drejtonin për një demokraci proletare socialiste! Këto pikëpamje e shtuan çoroditjen ideologjike në radhët e anëtarëve të grupit.

Midis dy grupeve u ashpërsuan mosmarrëveshjet ideologjike dhe politike në lidhje me zbatimin e marksizmit në kushtet konkrete historike të vendit. Kjo luftë u shtri edhe në fushën organizative dhe mori një karakter të paparim.

## **Lufta kundër agresionit fashist**

Ndërkaq, rreziku i agresionit fashist italian kundër Shqipërisë po shtohet gjithnjë më shumë. Në janar të vitit 1939 diktatori fashist Benito Musolini nënshkroi planin e pushtimit ushtarak të Shqipërisë. Udhëheqja e Grupit Komunist të Korçës mendoi se qenë krijuar kushte të volitshme për formimin e një fronti të gjerë kundër imperializmit italian. Ajo bëri përpjekje për t'i bindur komunistët e grupeve të tjera dhe nacionalistët patriotë mbi nevojën për t'u bashkuar dhe për të bashkëpunuar kundër agresionit fashist. Por këto përpjekje nuk ishin këmbëngulëse dhe dështuan.

Nga ana tjetër, Zogu nuk kishte aspak ndër mend të organizonte qëndresën kundër agresionit italian dhe aq më tepër në bashkëpunim me komunistët. Ai shpresonte deri në çastin e fundit të merrej vesh me fashistët italianë, duke u bërë atyre lëshime të reja për të siguruar fronin mbretëror. Në të njëjtën kohë, ai organizoi ndjekje të egra kundër komunistëve. Xhandarmëria zogiste zbuloi dhe arrestoi pjesën më të madhe të anëtarëve të Grupit të Shkodrës. Udhëheqësit e këtij grupi,

Zef Mala e Niko Xoxi, u gjunjzuan përpara hetuesisë dhe gjyqit zogist, që u zhvillua në janar 1939, duke kallëzuar shokët e tyre, veprimtarinë e grupit dhe një pjesë të anëtarëve të Grupit të Korçës. Përpara gjyqit dolën 75 veta, të pandehur se donin të rrëzonin regjimin me anën e forcës. Komunisti 18-vjeçar Qemal Stafa, ashtu si mjaft shokë të tij, mbajti një qëndrim burrëror përpara gjyqit. Ai deklaroi se ishte e do të mbetej komunist i bindur dhe se komunizmi do ta shpëronte masën e punëtorëve që ishin të shtypur. Gjyqi dha dënime të ndryshme për 52 veta.

Lëvizja komuniste shqiptare pësoi një goditje të rëndë. Kjo u shkaktua kryesisht nga konspiracioni i dobët dhe nga tradhtia e krerëve të Grupit Komunist të Shkodrës, të cilët nuk e quanin ndonjë gabim të rëndë kallëzimin e bashkëpunëtorëve të tyre përpara policisë dhe gjyqit. Këtë ata e vlerësonin si një mjet për të provuar shokët përpara torturave të armikut!

Gjendja ndërkombëtare sa vinte keqësohej. Shtetet fashiste i kishin shtuar shumë përgatitjet për luftë. Gjermania hitleriane kishte pushtuar më 1938 Austrinë dhe në mars 1939, pas kapitullimit të fuqive perëndimore në Munih, pushtoi Çekoslovakinë, ndërsa trupat fashiste në Spanjë i shtypën forcat republikane spanjolle.

Më 23 mars 1939 Italia fashiste mori vendimin përfundimtar për pushtimin ushtarak të Shqipërisë. Zogu u përpoq me të gjitha mënyrat për ta fshehur gjendjen e nderë të krijuar në marrëdhëniet shqiptaro-italiane. Megjithatë, populli shqiptar i mësoi planet e errëta të fashizmit qysh në ditët e para të prillit. Një valë e thellë zemërimi pushtoi mbarë vendin. Komunistët shqiptarë, ndonëse të paktë në numër, u bënë organizuesit e demonstratave të fuqishme antifashiste që shpërthyen në të gjitha anët. Në Tiranë dhe në qytete të tjera, me iniciativën e komunistëve e të nacionalistëve patriotë, u krijuan qendrat e rekrutimit të vullnetarëve për luftën kundër agresionit fashist. Komunistët e burgosur dhe të internuar i kërkuan qeverisë të dërgoheshin në vijën e parë të frontit kundër agresionit. Por organizimi i qëndresës popullore u sabotua nga Zogu dhe klika e tij. Populli shqiptar, i ngritur më këmbë, i gatshëm të luftonte për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarisë, u ndodh pa armë, i tradhtuar nga klasat sunduese,

nga qeveria dhe mbreti. Në këto çaste vendimtare për fatin e atdheut grupet komuniste, të përçara dhe në luftë me njëri-tjetrin, nuk mundën të krijonin një udhëheqje të vetme dhe të mobilizonin popullin për veprime të armatosura kundër agresorëve.

Më 7 prill 1939 trupat fashiste italiane sulmuan Shqipërinë. Zogu dhe klika e tij e braktisën vendin duke e lënë në mëshirën e fatit. Ushtria shqiptare, e paralizuar nga specialistët ushtarakë italianë dhe oficerët profashistë, u shtur pa bërë ndonjë qëndresë. Ndërkaq, grupe patriotësh luftuan heroikisht me armë në dorë kundër agresorëve në Durrës, Sarandë, Shëngjin, Shkodër, Vlorë etj. Por forcat e shumta armike e shtypën këtë qëndresë. Brenda pak ditësh fashistët pushtuan gjithë vendin. Mirëpo populli shqiptar nuk u mposht. Ai e shfaqti hapur urrejtjen e tij të thellë ndaj skllavëruesve italianë dhe nuk e njohu kurrë regjimin e pushtimit të huaj.

Pushtimi i Shqipërisë ishte përfundimi logjik i politikës agresive të fashizmit italian, i politikës kapitulluese antikom-bëtare dhe antipopullore të ndjekur nga regjimi zogist dhe i politikës së «mosndërhurjes» të fuqive kapitaliste perëndimore, të cilat e njohën këtë pushtim. Vetëm Bashkimi Sovjetik, besnik ndaj politikës së tij të mbrojtjes së vendeve të kërcënuara nga fashizmi, ngriti zërin kundër këtij agresioni. Një valë zemërimi e protestash përfshiu kolonitë shqiptare të mërgimit. Gjithashtu agresionin italian kundër Shqipërisë e dënoi mbarë opinionin përparimtar në botë.

#### 4. KRIJIMI I PARTISË KOMUNISTE — DOMOSDOSHMËRI HISTORIKE NË KUSHTET E LUFTËS PËR ÇLIRIMIN KOMBËTAR.

Pushtimi i Shqipërisë ishte pjesë e planit të përgjithshëm që fuqitë fashiste kishin filluar të vinin në jetë për vendosjen e sundimit botëror. Politika e lëshimeve të njëpasnjëshme që bënin Anglia, Franca, SHBA i kishte nxitur me shumë synimet agresive të fashizmit. Bisedimet me Bashkimin Sovjetik, që patën filluar më 1939 Anglia dhe Franca nën presionin e opinionit publik, u përdorën nga këto fuqi si perde për të fshehur orvatjen për marrëveshje me Hitlerin. Për këtë arsye, Bashkimi Sovjetik, me qëllim që të fitonte një farë

kohe, të forconte mbrojtjen dhe të mos hynte vetëm në një luftë në dy fronte — kundër Gjermanisë dhe Japonisë, përfundoi në gushtin e vitit 1939 traktatin e mossulimit me Gjermaninë. Në fillim të shtatorit, pasi hitlerianët sulmuan Poloninë, Anglia dhe Franca, të ndodhura përballë agresionit fashist që po drejtohej edhe kundër tyre, i shpallën luftë Gjermanisë naziste.

Lufta e Dytë Botërore filloi kështu si një luftë midis dy blloqeve kryesore imperialiste. Ajo ishte rrjedhim i kontraktave të pashmangshme të sistemit kapitalist në epokën e krizës së tij të përgjithshme. Por nga ana tjetër kundër agresionit e skllavërisë fashiste ishin ngritur popujt. Lufta e tyre për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë dhe për çlirim nga zgjedha e huaj ishte një luftë e drejtë antifashiste.

### **Vendosja e regjimit fashist të pushtimit**

Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, për popullin shqiptar filloi periudha e rëndë e robërisë fashiste.

Pushtuesit italianë ruajtën të paprekur rendin çifligaro-borqez. Nga ana tjetër ata vunë menjëherë në zbatim një plan të gjerë masash politike, ekonomike dhe administrative, të cilat kishin për qëllim të ligjësonin dhe të forconin regjimin e pushtimit.

Këtë qëllim fashistët italianë u përpoqën ta arrinin me anën e demagogjisë e të forcës. Për të fshehur aneksimin ata mblodhën në Tiranë «Asambleenë Kushtetuese», e cila shpalli «bashkimin personal» të Shqipërisë me Italinë, i dhuroi mbretit italian, Viktor Emanuelit III, kurorën e Shqipërisë dhe krijoi qeverinë kukull shqiptare, të kryesuar nga çifligari i madh, Shefqet Vërlaci. Në të vërtetë Shqipëria u kthye në një provincë të perandorisë italiane, ku u vendos diktatura fashiste. «Mëkëmbësia (Luogotenenza) e Përgjithshme» italiane ushtronte në emër të mbretit gjithë pushtetin shtetëror, duke zbatuar besnikërisht urdhrat e qeverisë së Romës. Qeveria kukull shqiptare nuk ishte veçse një përçuese e thjeshtë e vullnetit të diktatorit fashist Musolinit dhe Mëkëmbësit të Përgjithshëm. Ministria e Jashtme shqiptare u mbyll. Të drejtat e saj i kaluan Ministrisë italiane të Punëve të Jashtme. Ministrinë e tjera drejtoheshin në të vërtetë nga «këshilltarët» italianë. Forcat e armatosura shqiptare u bënë pjesë e ushtrisë perandorake dhe vareshin nga komanda italiane. Konventa mbi



«barazinë e të drejtave civile dhe politike» në Shqipëri midis shtetasve italianë e shqiptarë u shoqërua me vërshimin e dhjetëra mijë kolonëve italianë (punëtorë, bujq, specialistë, arsimtarë, sipërmarrës, tregtarë, nëpunës e të tjerë). Këta bashkë me trupat e pushtimit përbënin forcën që kishte për qëllim, përveç të tjerave, kolonizimin dhe fashistizimin e plotë të vendit.

Pushtuesit italianë i shpallën zyrtarisht Italinë dhe Shqipërinë «një tokë të vetme». Kapitali italian vërshoi pa asnjë pengesë në Shqipëri dhe u bë zot i plotfuqishëm i ekonomisë së vendit, duke e shndërruar plotësisht këtë në një bazë lëndësh të para dhe në një treg vetëm për mallrat e veta.

Qeveria italiane filloi gjithashtu përgatitje të ethshme për ta bërë Shqipërinë një bazë ushtarake që do të shërbente për agresionin kundër vendeve fqinje të Ballkanit.

Në politikën e vet të pushtimit dhe të shndërrimit të Shqipërisë në një provincë të Italisë qeveria e Musolinit gjeti përkrahjen e plotë nga ana e klasave sunduese reaksionare të vendit. Qysh para 1939-s Italia fashiste kishte krijuar në radhët e këtyre klasave dhe në radhët e të mërguarve politikë borgjezë një agjunkturë të fortë, e cila i shërbeu besnikërisht për skllavërimin e popullit shqiptar.

Çifligarët shqiptarë kanë qenë gjithnjë të lidhur me sunduesit e huaj, të cilët u siguronin privilegjet klasore, dhe të prirur për të vënë interesat e pronës mbi ato të kombit. Si bartës tradicionalë të korrupsionit politik, duke gjetur te fashizmi italian mbrojtësin e interesave të tyre klasore, ata nuk e patën vështirë të braktisnin Zogun, të lidheshin ngushtë me pushtuesit italianë dhe të përkrahnin pa rezerva politikën e tyre në Shqipëri. Të njëjtat interesa i hodhën në prehrin e fashizmit edhe bajraktarët. Pushtuesit italianë i bënë ata vegla të verbra të fashizmit në Shqipëri.

Interesat e atdheut i tradhtoi edhe borgjezia reaksionare shqiptare, pjesën më të rëndësishme të së cilës e përbënte borgjezia e madhe tregtare. Ajo kishte hequr dorë prej kohësh nga lufta për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendit dhe ishte shndërruar në një forcë kundërrevolucionare e antikombetare. Pushtimi fashist i dha hov zhvillimit të tregtisë. Tregtarët e mëdhenj shqiptarë së bashku me çifligarët e me nëpunësit e lartë fashistë u bënë ndërmjetës e bashkëpunë-

torë të monopoleve italiane për shfrytëzimin e popullit shqiptar. Edhe mjaft pronarë të atyre fabrikave të vendit që u mbyllën për shkak të vështirësive të krijuara nga konkurrenca e industrisë italiane u hodhën në tregti dhe grumbulluan kapitale të rëndësishme. Borgjezia e madhe u bë kështu një shtojcë e pushtuesve. Vegël e fashizmit u bë edhe kleri reaksionar.

Përfaqësuesve të këtyre klasave e shtresave shoqërore, që përbënin reaksionin shqiptar, pushtuesit u dhanë vende të rëndësishme në administratën fashiste, duke shpresuar se me anën e tyre do të siguronin një sundim të qetë në Shqipëri.

Pasojat e vendosjes së regjimit fashist i ndjeu shumë shpejt populli shqiptar. Ai humbi krejt lirinë e pavarësinë kombëtare. Në burgjet dhe në kampet e internimit të Italisë u dërguan qysh në fillim qindra patriotë. Fashistët krijuan një aparat të fuqishëm policor për të gjurmuar «personat e dyshimtë për regjimin». Nëpunësit u detyruan të betoheshin për besnikërinë ndaj mbretit, përndryshe pushoheshin nga puna. Ligjet fashiste krijuan në gjithë vendin një atmosferë terrori e pasigurie.

Nga ana tjetër, u shua shumë shpejt mendimi i rremë i përmirësimit të gjendjes ekonomike, i krijuar në muajt e parë nga zgjerimi i ndërtimeve, sidomos me karakter ushtarak, që kishte zhdukur përkohësisht papunësinë dhe nga mbushja e tregut me mallra italiane më të lira se më parë. Punishtet zejtare filluan të mbylleshin njëra pas tjetrës nga konkurrenca e fortë e industrisë italiane. Rrënimi i zejtarëve mori karakter të përgjithshëm. Punëtorët shqiptarë ishin të detyruar të punonin 10 orë në ditë me një pagë që, në kushtet e rritjes së vazhdueshme të çmimeve, ishte një mëditje urie. Diskriminimi ndaj punëtorëve shqiptarë në krahasim me punëtorët italianë pas pushtimit mori përpjesëtime edhe më të mëdha. Për punëtorët shqiptarë nuk kishte as mbrojtje e as sigurim në punë. Sipërmarrjet italiane kishin të drejtë ta zgjatnin ditën e punës kur e gjykonin të nevojshme.

Grabitjet sistematike të pushtuesve prekën rëndë edhe interesat e fshatarëve. Dorëzimi i detyrueshëm i prodhimeve bujqësore me çmime shumë të ulëta, shpronësimi i fshatarëve të vegjël nga bankat italiane dhe rrëmbimi i mijëra hektarëve tokë për nevojat ushtarake e thelluan procesin e varfërimit të masave fshatare.

**Fillimet e lëvizjes nacionalçlirimtare.  
Në rend të ditës:  
bashkimi i komunistëve**

Humbja e lirisë  
dhe e pavarësisë  
kombëtare preku  
thellë ndjenjat

tradicionale të atdhedashurisë së flaktë dhe të krenarisë kombëtare të popullit shqiptar. Urrejtja për pushtuesit erdhi gjithnjë duke u rritur. Kjo urrejtje u shpreh në forma të ndryshme: në sabotimin e planeve për italianizimin e fashistizimin e popullit shqiptar, në kundërshtimin për t'u regjistruar në parti në dhe organizatat e tjera fashiste, në qëndresën kundër ligjeve të regjimit të pushtimit etj. Në qëndresën antifashiste dalloheshin sidomos punëtorët dhe rinia shkollore.

Lëvizja punëtore në kushtet e pushtimit mori karakter politik antifashist të theksuar. Fabrikat e kantieret e mëdha u bënë vatra të luftës kundër shfrytëzuesve kapitalistë dhe kundër pushtuesve. Greva të shpeshta e të shumta shpërthyen në qytete të ndryshme. Me anën e tyre punëtorët jo vetëm luftonin për kërkesa ekonomike, por edhe shprehnin zemërimin e sabotonin prodhimin për pushtuesit.

Çerdhe të një lëvizjeje të zjarrtë kundër fashizmit u bënë shkollat e mesme. Edhe përpara pushtimit rinia shkollore ishte dalluar për ndjenjat e saj patriotike e demokratike. Nën ndikimin dhe udhëheqjen e grupeve komuniste ajo ishte bërë luftëtare e vendosur kundër regjimit zogist, kundër obskuranizmit dhe kundër fashizmit. Veç kësaj, ajo ishte bërë përçuese e ideve komuniste e demokratiko-revolucionare në masat. Pas pushtimit, të rinjtë e shkollave ishin nga të parët që shfaqën me një forcë të madhe urrejtjen kundër pushtuesve fashistë. Ata kundërshtonin e sabotonin përhapjen e kulturës fashiste, qëndronin në ballë të demonstratave e të protestave kundër fashizmit, propagandonin idetë e patriotizmit luftarak e të komunizmit. Në këtë mënyrë, rinia shkollore shërbente si një mbështetje e shëndoshë e lëvizjes komuniste dhe antifashiste në përgjithësi.

Gjendja e re e krijuar pas pushtimit shtronte si detyrë themelore ngritjen e gjithë popullit në luftë për të shkatërruar planin fashist të italianizimit e të grabitjes së vendit, për të çliruar Sheqipërinë dhe për të fituar pavarësinë kombëtare.

Për plotësimin e kësaj detyre ishte e nevojshme një udhëheqje revolucionare, e cila të përpunonte platformën politike

të luftës antifashiste, të mobilizonte dhe të organizonte popullin në këtë luftë.

Një udhëheqje e tillë mungonte. Grupet komuniste ishin të vetmet organizata politike, të cilave u binte të mendonin për fatin e atdheut e të popullit në ato çaste të rënda. Këto grupe mbajtën një qëndrim të vendosur kundër regjimit të pushtimit. Por përçarja i pengonte të përpunonin një vijë të përbashkët të luftës çlirimtare, të lidheshin me masat popullore dhe të viheshin në krye të tyre.

Në rend të ditës shtrohej me forcë domosdoshmëria e bashkimit të grupeve dhe e krijimit të një partie të vetme komuniste. Zgjidhja e kësaj detyre nuk ishte e lehtë. Duheshin kapërcyer pengesa të mëdha për zhdukjen e mosmarrëveshjeve dhe të përçarjes që ushqeheshin sidomos nga drejtuesit, megjithëse nevoja e bashkimit ndihej tani shumë nga pjesa më e madhe e komunistëve.

Por për t'ia arritur bashkimit të forcave komuniste dhe organizimit të luftës antifashiste u ndoq rruga e vjetër, ajo e bisedimeve midis krerëve. Në këto bisedime u ndeshën përsëri dy vijat e kundërta në lidhje me karakterin e luftës. Udhëheqësit e Grupit të Korçës ishin gjithnjë për organizimin e luftës nacionalçlirimtare me pjesëmarrjen e të gjitha klasave e shtresave shoqërore që donin të luftonin kundër pushtuesve të huaj. Krerët e Grupit të Shkodrës dhe të organizatave të tjera, që nuk kishin hequr dorë nga qëndrimi i tyre sektar, ia përshtatën pikëpamjet e tyre të vjetra edhe gjendjes së re. Ata mendonin se me pushtimin italian Shqipëria po hynte në rrugën e zhvillimit të shpejtë kapitalist. Si rrjedhim, rritja e klasës punëtore krijonte bazën për revolucionin socialist!

Bisedimet midis krerëve të Grupit të Korçës dhe të Grupit të Shkodrës çuan në formimin, në vjeshtë të vitit 1939, të një të ashtuquajturit «Komitet Qendror» të përbashkët, me një numër të barabartë anëtarësh, dy për secilin grup. Kjo marrëveshje s'ishte gjë tjetër veçse një «kompromis socialdemokrat»<sup>1</sup>. Ajo nuk parashikonte shkrirjen e grupeve në një organizatë të vetme. Grupet mbeteshin përsëri të ndara duke

---

1 Rezolucioni i Mbledhjes së Grupeve Komuniste, nëntor 1941. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, 1971, f. 17.

ruajtur secili pikëpamjet e veta dhe nuk spastronin radhët nga elementët antimarksistë. Udhëheqësit e Grupit të Shkodrës pranuan vetëm të përjashtonin trockistin Niko Xoxi. I ndërtuar mbi të tilla baza të kalbëta, ky «bashkim» i bërë nga lart mbeti krejt formal.

Ndërkohë, në gjithë vendin po rritej lëvizja popullore antifashiste. Në krye të saj qëndronin komunistët. Me pushtimin e vendit në ndërgjegjen e tyre ishte bërë një kthesë rrënjësore. Anëtarët e thjeshtë të grupeve po e kuptonin gjithnjë e më tepër se bashkimi mund të arrihej jo me bisedime shterpë midis krerëve, por në luftën e përbashkët kundër pushtuesve fashistë. Kjo solli me vete që mosmarrëveshjet politike dhe ideologjike të kalonin dalngadalë në plan të dytë. Autoriteti dhe ndikimi i krerëve mbi anëtarët e thjeshtë të grupeve kishte rënë. Komunistët u hodhën në luftë kundër pushtuesve të huaj dhe u bënë agjitorë për luftën çlirimtare. Nën udhëheqjen e tyre, me rastin e festës kombëtare të 28 Nëntorit 1939, shpërthyen demonstrata masive antifashiste në qytetet kryesore të vendit. Demonstratat u zhvilluan me parullat: «Rroftë Shqipëria e lirë!», «Ja vdekje, ja liri!». Komunistët ishin frymëzuesit dhe udhëheqësit e lëvizjes antifashiste të punëtorëve e të rinisë shkollore. «Në luftë dhe në përpjekje me okupatorin dhe me kuislingët, të bashkuar për një qëllim, për çlirimin e vendit nga okupatori, komunistët e shëndoshë të bazës së grupeve të ndryshme po lidheshin me gjak me njëri-tjetrin dhe harronin zënkat dhe mëritë. Tani po kristalizohej në ta vija e drejtë e komunistëve dhe kërkohesh bashkimi në një parti të vetme, konditë sine qua non për organizimin e luftës së çlirimit dhe për drejtimin e saj»<sup>1</sup>.

Arritjet e komunistëve në organizimin e lëvizjes antifashiste në muajt e parë pas pushtimit të vendit shërbyen si nxitje për Grupin Komunist të Korçës që të forconte dhe të zgjeronte veprimtarinë e vet në krahinat e tjera të vendit dhe t'i jepte fund lokalizmit. Në fillim të vitit 1940 ai organizoi një degë të vet në Tiranë. Në krye të kësaj dege u vu Enver Hoxha.

---

<sup>1</sup> Enver Hoxha. Raport i KQ të PKSH në Kongresin I të Partisë Komuniste të Shqipërisë, 8 nëntor 1948. Vepra, vëll. 5, f. 245.

**Enver Hoxha** Enver Hoxha lindi më 16 tetor 1908 në Gjirokastrë. Ai e kaloi fëmijërinë në një periudhë mjaft të rëndë për vendin, kur pushtuesit e huaj, që pasonin njëri-tjetrin, dogjën e shkatërruan krahina të tëra, vranë në masë popullsinë dhe mbollën kudo mjerimin. Jeta e mësoi t'i urrente armiqtë e atdheut dhe të bashkohej, ndonëse fare i ri, me lëvizjen demokratike të 1924-ës.

Në liceun e Korçës, të cilin e mbaroi më 1930, Enver Hoxha njohu për herë të parë dhunën e autoriteteve zogiste dhe burgun, për shkak se organizoi bashkë me shokë të tij një protestë kundër kusërive që bëheshin në kurriz të nxënësve.

Ai shkoi në Francë për të vazhduar studimet e larta. Prirjet e tij të theksuara demokratike e bënë Enver Hoxhën një simpatizant të lëvizjes komuniste franceze. Në Paris ai vendosi lidhje me redaksinë e gazetës «Ymanite», organ i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Franceze, ku filloi të bashkëpunonte me materiale që demaskonin regjimin zogist në Shqipëri.

Prerja e bursës e detyroi Enver Hoxhën të shkonte në Belgjikë, ku punoi për disa kohë pranë konsullatës shqiptare në Bruksel dhe njëkohësisht vazhdoi studimet. Por agjentët e Zogut jashtë atdheut e zbuluan veprimtarinë e tij antizogiste. Ai u pushua nga puna dhe u detyrua të kthehej në Shqipëri më 1936.

Enver Hoxha ishte bërë tanimë komunist dhe, si i tillë, iu kushtua luftës për çlirimin e popullit. Betimi që bëri më 1936 mbi varrin e patriotit Bajo Topulli në Gjirokastrë se ai dhe gjithë të rinjtë do të luftonin «për një Shqipëri më të mirë», «për mbarëvajtjen e atdheut», «për bashkimin e vërtetë të kombit» ishte një program lufte për të.

Enver Hoxha filloi veprimtarinë e tij revolucionare në atdhe si mësues në gjimnazin e Tiranës, pastaj në liceun e Korçës. Ai u lidh me Grupin Komunist të Korçës dhe u bë një nga anëtarët e tij më veprues. Ai përdori me mjeshtëri tribunën shkollore për t'i pajisur nxënësit me idetë demokratike e komuniste. U bë gjithashtu një nga edukuesit kryesorë të organizatës jashtëshkollore «Rinia Korçare» dhe një militant i palodhur për bashkimin e lëvizjes komuniste shqiptare.

Në pragun e pushtimit fashist Enver Hoxha punoi me mish e me shpirt së bashku me shokët e tjerë të Grupit për

të organizuar qëndresën popullore. Ai i vazhdoi këto përpjekje edhe pas pushtimit të vendit. Veprimtaria e tij revolucionare ra në sy të pushtuesve fashistë, të cilët e pushuan nga puna me motivacionin: «element kundër regjimit». Me vendim të qendrës së Grupit Komunist të Korçës ai u dërgua në Tiranë me detyrë që ta zgjeronte mbi baza të shëndosha veprimtarinë e Grupit, duke organizuar lëvizjen antifashiste në kryeqytet dhe në krahina të tjera të vendit.

Duke e çmuar vendosmërinë e anëtarëve të thjeshtë të grupeve komuniste për të luftuar kundër fashizmit dhe dëshirën e tyre të zjarrtë për bashkimin e lëvizjes komuniste dhe themelimin e partisë, Enver Hoxha, i zhveshur nga fryma e grupazhit, zhvilloi ndër ta me durim e urtësi një punë të palodhur sqaruese dhe organizuese. Ai vendosi njëkohësisht lidhje me nacionalistë patriotë që e urrenin pushtuesin fashist dhe ishin të gatshëm të luftonin kundër tij.

### **Vështirësi të reja në rrugën e bashkimit. Grupi i Të Rinjve**

Pikërisht në kohën kur bashkimi i grupeve dhe krijimi i një partie të vetme komuniste ishte bërë një nevojë e domosdoshme,

u ndeshën vështirësi të reja në rrugën për arritjen e këtij qëllimi. Një fraksion, që kishte filluar të formohej në gjirin e Grupit Komunist të Korçës qysh para pushtimit të vendit, që nga shkurti i vitit 1940 filloi të dilte si një grup më vete. Më vonë ai mori emrin **Grupi i Të Rinjve**. Lindjen e këtij grupi të ri e kishin ndihmuar përcarja dhe dobësitë e tjera në lëvizjen komuniste, faktorë që krijojnë një truall të përshtatshëm për veprimtarinë e elementëve antimarksistë.

Në krye të Grupit qenë vënë Anastas Lula dhe Sadik Premtja, elementë me prirje të theksuara trockiste e anarkiste. Duke shfrytëzuar mungesën e lidhjeve të shëndosha të Grupit të Korçës me organizatat e veta në Tiranë, Anastas Lula dhe Sadik Premtja kishin arritur t'i bindnin elementët e rekrutuar prej tyre se udhëheqja e Grupit të Korçës nuk ishte e aftë të drejtonte lëvizjen komuniste dhe se pikëpamjet ideologjike e vija e saj politike ishin të gabuara. Ata mundën shumë shpejt të zgjeronin radhët e fraksionit të tyre me elementë intelektualë me origjinë borgjeze e mikroborgjeze, të cilët pikëpamjet antimarksiste, të huajtura pjesërisht nga krerët e Grupit të Shkodrës, zunë rrënjë menjëherë. Grupi i Të Rinjve

krijoi degë në qytete kryesore të vendit, edhe në Korçë, ku përfitoi nga shpërndarja e celulave që kishte lënë të pakënaqur e kishte çorientuar një pjesë të komunistëve.

Grupi i Të Rinjve filloi të shkelte hapur vendimet e përbashkëta të «Komitetit Qendror». Krerët e Grupit të Shkodrës, duke kujtuar se këta fraksionistë vepronin sipas udhëzimeve të Grupit të Korçës, ku formalisht bënin pjesë, e akuzuan atë për mungesë sinqeriteti dhe pabesi. Ata e përdorën këtë si shkas për t'u larguar nga «Komiteti Qendror», duke shkaktuar kështu shpërndarjen e tij.

Në këtë mënyrë marrëveshja e vjeshtës 1939 u prish. Në vend që të arrihej afrimi dhe bashkimi, u thellua hendeku midis grupeve. Grupi i Të Rinjve i shpalli luftë të hapur Grupit të Korçës dhe vendosi lidhje me Grupin e Shkodrës. Organizatat e vogla komuniste u shkrinë dalngadalë në tre grupe kryesore komuniste.

Udhëheqja e Grupit të Të Rinjve doli me një platformë ideologjike dhe politike antimarksiste. Ajo thoshte se në Shqipëri mungonte proletariati, nuk ekzistonte lufta e klasave, pra nuk kishte edhe një bazë për formimin e partisë komuniste, se fshatarësia ishte konservatore, reaksionare, dhe nuk mund të bëhej aleate e klasës punëtore. Ajo kishte përvetësuar teorinë trockiste mbi edukimin dhe ruajtjen e kuadrove. Lidhjet me masat dhe punën me to i quante të dëmshme, sepse rrezikonin kuadrot! Ashtu si Zef Mala e Niko Xoxi, krerët e Të Rinjve mendonin se me pushtimin fashist do të zhvillohej kapitalizmi, do të rritej proletariati, do të forcoheshin lidhjet e punëtorëve shqiptarë me punëtorët italianë dhe kështu do të zhvillohej lufta e klasave e do të krijoheshin kushtet për themelimin e partisë komuniste, e cila do të udhëhiqte luftën për socializëm!

Krerët e Grupit të Të Rinjve dhe një pjesë e pasuesve të tyre degjeneruan në një sekt anarkistësh.

Konfuzionin e shkaktuar nga formimi i Grupit të Të Rinjve e shtoi edhe më shumë krijimi në të njëjtën kohë, brenda në Shqipëri, i organizatave të Grupit të «Zjarrit». Trockisti Andrea Zisi, pasi kishte penguar me të gjitha mënyrat në emër të «partisë komuniste shqiptare» të rinjtë antifashistë shqiptarë në Athinë që dëshironin të vinin në atdhe për të luftuar me armë në dorë kundër agresionit italian, u kthye



në Shqipëri për të sabotuar lëvizjen komuniste dhe antifashiste. Ai formoi në Korçë një «komitet qendror» dhe në Tiranë e në Vlorë nga një «komitet qarkor». Andrea Zisi kishte shpikur një «teori» të re, sipas së cilës kalaja fashiste duhej marrë nga brenda dhe prandaj komunistët, në vend që të luftonin hapur kundër pushtuesve, duhej të shkriheshin në aparatet e tyre politik dhe administrativ! Këto pikëpamje u përfaqëuan edhe nga disa oficerë komunistë me nxitjen e Bedri Spahiut.

### **Qëndrimi i komunistëve dhe i popullit shqiptar ndaj agresionit fashist kundër popujve fqinj**

te, në qershor 1940 Italia hyri në luftë përkrah Gjermanisë hitleriane. Fashistët italianë u përpoqën t'i tërhiqnin pas vete edhe shqiptarët e t'i përdornin si mish për top. Më 28 tetor 1940 trupat italiane, të nisura nga Shqipëria, sulmuan Greqinë. Pas një përparimi të vogël, ato u detyruan të tërhiqeshin nën goditjet e ushtrisë greke, duke lëshuar Korçën në nëntor e Gjirokastrën në fillim të dhjetorit 1940.

Lufta Italo-Greke i solli vuajtje e shkatërrime të reja popullit shqiptar. Ky jo vetëm nuk u solidarizua me agresionin fashist kundër Greqisë, por bëri ç'ishte e mundur për ta ndihmuar popullin vëlla grek në luftën e tij çlirimtare. Puna e komunistëve dhe e patriotëve antifashistë bëri që plani fashist i mobilizimit ushtarak dhe i «mobilizimit civil» të shqiptarëve të dështonin plotësisht. Ushtarët shqiptarë, të dërguar me forcë nga fashistët italianë në frontin grek, nuk pranuan të luftonin dhe dezertuan në masë. Sabotimet kundër makinës ushtarake fashiste u bënë më të shpeshta edhe në prapavijat. Duke pasur si armik të përbashkët fashizmin italian, popullsia e zonave të pushtuara nga forcat greke i ndihmoi këto me sa mundi. Por qeveria greke mbajti një qëndrim të hapur shovinist ndaj popullit shqiptar. Ajo u përpoq të vinte në jetë planet e vjetra të borgjezisë grekomadhe për aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës.

Në këtë qëndrim armiqësor të autoriteteve greke të pushtimit ndeshën edhe komunistët e Korçës. Me t'u larguar prej këtej ushtria italiane, komunistët formuan «Komitetin

për Mbrojtjen e Qytetit» dhe krijuan një forcë të vogël të armatosur me komunistë e simpatizantë të grupit për ruajtjen e qetësisë. Qysh në takimin e parë midis «Komitetit të Mbrojtjes» dhe autoriteteve ushtarake greke lindi konflikti në lidhje me karakterin e pushtimit grek. Komiteti e hodhi poshtë kërkesën e Athinës për ta cilësuar ardhjen e ushtrisë greke si «çlirim të Korçës greke». Grekët, nga ana e tyre, nuk e pranuan kërkesën e komitetit për formimin e disa batalioneve shqiptare, të cilat do të luftonin me flamurin kombëtar kundër pushtuesve italianë. Ata e detyruan komitetin të shpërndahej. Më 28 Nëntor 1940, ditën e pavarësisë, komunistët organizuan një demonstratë të madhe në qytetin e Korçës për të mbajtur lart moralin e popullsisë dhe për t'i treguar qeverisë greke se Korça, si gjithë populli shqiptar, i urrente fashistët italianë, por nuk pranonte as pretendimet e shovinistëve grekë mbi tokën shqiptare.

Pushtimi grek i krahinave të Jugut nuk zgjati shumë. Ngjarjet që u zhvilluan në pranverën e vitit 1941 e ndryshuan krejt gjendjen në Ballkan. Gjermania hitleriane, pasi kishte pushtuar Danimarkën, Norvegjinë, Holandën, Belgjikën e Francën, futi trupat e veta në Finlandë, Rumani e Bullgari dhe, në prill të vitit 1941, sulmoi Jugosllavinë e Greqinë. Brenda pak ditëve ushtria gjermane i pushtoi këto vende dhe u dha mundësi trupave italiane të ripushtonin Shqipërinë e Jugut e të hynin në Greqi.

Lufta Italo-Greke, gjatë së cilës Shqipëria u shndërrua në një shesh lufte, pati këtu pasoja të rëndësishme. Humbjet në njerëz, dëmet e mëdha materiale dhe forcimi i politikës grabitqare kolonialiste të pushtuesve e keqësuan së tepërmi gjendjen e masave popullore. Por disfatat e pësuar nga Italia në këtë luftë treguan qartë kalbësinë e fashizmit italian dhe e diskredituan atë plotësisht në sytë e popullit shqiptar.

Italia e zgjeroi zonën e saj të pushtimit duke krijuar «Shqipërinë e madhe», ku përfshihej edhe një pjesë e tokave shqiptare që i qenë dhënë Serbisë nga Konferenca e Ambasadorëve të fuqive imperialiste në Londër më 1913. Për të siguruar pozitat e tyre në Ballkan, pushtuesit fashistë gjermanë dhe italianë nxitën grindjet e vjetra kombëtare dhe shovinizmin e klasave reaksionare të vendeve ballkanike. Por komunistët dhe i gjithë populli nuk ranë në kurthin e demagogjisë fashiste. Ata e demaskuan politikën provokuese të

«Shqipërisë së madhe» dhe ndoqën rrugën e ashpërsimit të luftës kundër pushtuesve fashistë dhe të bashkëpunimit me popujt fqinj në luftën çlirimtare kundër armikut të përbashkët, duke u mbështetur në të drejtën e vetëvendosjes së popujve.

### **Bashkimi i komunistëve në luftë kundër fashizmit**

Regjimi fashist në Shqipëri kishte pësuar një tronditje të rëndë. Ai hyri në periudhën e një krize politike që u thellua gjithnjë e më tepër e që u shpreh, përveç të tjerave, në paaftësinë e tij për të shtypur lëvizjen popullore antifashiste. Në pranverë të vitit 1941 çeta e drejtuar nga patrioti Myslim Peza kishte filluar të kryente veprime të armatosura kundër pushtuesve fashistë. Aksioneve të saj, të kryera në mars dhe në maj, pushtuesit iu përgjigjën me operacionin e parë ndëshkimor që zhvilluan në Pezë. Nga radhët e reparteve shqiptare filluan dezertimet në masë. Në maj urrejtja popullore kundër shtypësve të huaj u shpreh me një akt të shënuar. I riu Vasil Laçi qëlloi me armë në mes të kryeqytetit mbretin e Italisë, Viktor Emanuelin III, që kishte ardhur për një vizitë në Shqipëri.

Në Shqipëri po piquej gjithnjë e më shumë situata revolucionare. Pushtuesit fashistë i shtuan masat shtypëse. Ata arrestuan e burgosën me mijëra patriotë. Një pjesë e tyre, për t'u shpëtuar ndjekjeve policore ose rekrutimit ushtarak, kishin marrë malet dhe vepronin kundër armikut veç e veç ose në grupe të vogla të armatosura.

Duke çmuar rëndësinë e çetës patriotike të Pezës, Enver Hoxha me shokët e tij vendosën të dërgonin pranë saj komunistë, të cilët do t'i jepnin karakter të organizuar e do të ngrinin ndërgjegjen politike të luftëtarëve të saj. Në takimet që bëri Enver Hoxha me Myslim Pezën ky e pranoi me kënaqësi propozimin për të dërguar komunistë në radhët e çetës.

Vajtja e komunistëve në mal për të organizuar e zgjeruar lëvizjen nacionalçlirimtare shënonte fillimin e një etape të re në veprimtarinë e tyre. Komunistët morën iniciativën dhe bënë përpjekje për organizimin e lëvizjes së armatosur antifashiste edhe në krahinat e tjera të vendit.

Përpjesëtime të gjera po merrte puna propagandistike e tyre në masat popullore. Përveç agjitacionit individual, një

rol të rëndësishëm në komunikimin e komunistëve me masat luajtën traktet e thirrjet që filluan të shpërndareshin në qytete, pastaj edhe në fshatra. Por në një pjesë të tyre gjendeshin parulla politikisht të gabuara: «Për Shqipërinë sovjetike», «Për Shqipërinë komuniste», «Për organizimin e ushtrisë së kuqe shqiptare», të cilat e kishin zanafillën te vlerësimi jo i drejtë i gjendjes së krijuar në Shqipëri.

Zhvillimi i lëvizjes dhe kërkesat këmbëngulëse të komunistëve për bashkim nxitën në këtë kohë Grupin e Korçës dhe të Shkodrës të bënin një orvatje të re për të vendosur bashkëpunimin. Me qëllim që të bashkërendonin veprimet antifashiste, krijuan një «komision arbitrazhi» si hap të parë për të kaluar në bashkimin e plotë. Por edhe kjo orvatje nuk dha përfundime të kënaqshme.

Dega e Grupit Komunist të Korçës në Tiranë, nga ana e saj, kishte zhvilluar një veprimtari të gjerë në radhët e komunistëve dhe në rrethet e nacionalistëve patriotë, duke krijuar lidhje të shëndosha me ta. Enver Hoxha, i frymëzuar nga dëshira e flaktë për të arritur sa më parë bashkimin e komunistëve shqiptarë në një parti të vetme, nuk ishte tërhequr përpara vështirësive të reja që kishin lindur nga puna fraksioniste e Të Rinjve dhe e zjarristëve. Ai gjeti një gjuhë të përbashkët me aktivistët e shquar të Grupit të Shkodrës, Vasil Shanton e Qemal Stafën. Dega e Tiranës, e kryesuar nga Enver Hoxha, u bë dalngadalë qendra e vërtetë organizuese për gjithë lëvizjen komuniste dhe antifashiste në Shqipëri. Ajo doli mbi grupet. Rreth saj u bashkuan komunistë të vendosur të grupeve të ndryshme. Veprimi revolucionar në luftën kundër fashizmit i kishte shoshitur komunistët, në radhë të parë krejtë e grupeve. Lufta e përbashkët kundër armikut kryesor të popullit shqiptar e të mbarë popujve të botës u bë kështu një bazë reale për bashkimin e komunistëve. Çështjes së bashkimit i shërbente shumë edhe përpunimi nga Enver Hoxha i vijave themelore të platformës së luftës antifashiste nacionalçlirimtare, mbi të cilën do të mbështetej ky bashkim.

Në kohën që qëndresa antifashiste e popullit shqiptar po rritej dita-ditës, një ngjarje e rëndësishme e ndryshoi rrënjësisht gjendjen politike ndërkombëtare. Gjermania hitleriane sulmoi pabesisht, më 22 qershor 1941, Bashkimin Sovjetik. Imperializmi gjerman vendosi të asgjësonte shtetin e parë socialist.

Populli sovjetik, i udhëhequr nga Partia Komuniste me J. Stalinin në krye, u ngrit si një trup i vetëm në Luftën e tij të madhe Patriotike për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e atdheut të vet socialist. Kjo luftë e drejtë hapi një etapë të re në Luftën e Dytë Botërore, përforcoi karakterin çlirimtar antifashist të luftës së popujve kundër bllokut fashist dhe hodhi themelet për bashkimin në një front të vetëm të të gjitha forcave antifashiste në botë.

Masat e shfrytëzuara në të gjithë botën ishin të interesuara për fitoren e Bashkimit Sovjetik. Popujt e vendeve të robëruara shikonin me të drejtë tek ai garancinë kryesore që lufta antifashiste të çohet deri në fund, deri në çlirimin e tyre nga pushtuesit fashistë. Të ndodhura përballë një armiku të rrezikshëm, siç ishte Gjermania hitleriane, dhe nën presionin gjithnjë më të madh të popujve të tyre që kërkonin krijimin e një koalicioni të fuqishëm antifashist, qeveritë e të dy fuqive më të mëdha kapitaliste — Anglisë dhe SHBA — hynë në aleancë me Bashkimin Sovjetik, i cili u bë forca kryesore e kësaj aleance antifashiste.

Sulmi i pabesë fashist kundër popullit sovjetik dhe fillimi i Luftës së madhe Patriotike patën jehonë të thellë në Shqipëri. Pushtuesit italianë, që i kishin shpallur gjithashtu luftë Bashkimit Sovjetik, dhe reaksioni i brendshëm, të dëhur nga fitoret e para naziste, shpërthyen një fushatë të tërbuar antisovjetike dhe antikomuniste, kurse masat e gjera të patriotëve shqiptarë e pritën me zemërim agresionin hitlerian.

Dashuria e patriotëve shqiptarë për Bashkimin Sovjetik kishte arsyet e veta historike. Në luftën shekullore kundër shtypësve të huaj populli shqiptar ishte ndodhur pothuajse gjithnjë vetëm, pa aleatë. Shtetet kapitaliste ose kishin mbajtur ndaj tij qëndrim të hapur armiqësor ose ishin treguar «miq» të tij me qëllim që t'i vinin thikën pas shpine e ta fusnin nën kontrollin e tyre. Vetëm Bashkimi Sovjetik socialist kishte mbrojtur të drejtat e Shqipërisë dhe kishte ngritur zërin kundër padrejtësive që ishin bërë në kurriz të saj. Me hyrjen e Bashkimit Sovjetik në luftën kundër fashizmit, populli shqiptar, për herë të parë në historinë e tij, kishte një mik e aleat lufte të fuqishëm e të sigurtë dhe, ashtu si popujt e tjerë të shtypur, një garanci të fortë për shkatërrimin e pashmangshëm të bllokut fashist. «Lufta jonë, — ka thënë shoku

Enver Hoxha, — nuk filloi pas hyrjes së Bashkimit Sovjetik në luftë, por pas hyrjes në luftë të Bashkimit Sovjetik populli ynë e ndjeu se gjaku i derdhur nuk do t'i shkojë kot»<sup>1</sup>.

Në rrethanat e reja, të krijuara me formimin e koalicionit antifashist të popujve që kishte si pararojë Bashkimin Sovjetik, komunistëve shqiptarë u binte një përgjegjësi e madhe historike: t'i siguronin sa më parë popullit shqiptar udhëheqjen politike, duke formuar partinë komuniste si kushtin themelor për organizimin, drejtimin dhe zgjerimin e luftës antifashiste nacionalçlirimtare. Tjetër rrugë nuk kishte dhe askush tjetër përveç komunistëve në kushtet konkrete historike të vendit nuk ishte në gjendje ta merrte përsipër një detyrë të tillë. Këtë e kuptuan më së miri komunistët e shëndoshë internacionalistë të grupeve. Pavarësisht nga mosmarrëveshjet ideologjike që kishin midis tyre, komunistët shqiptarë i bashkonte dashuria e pakufishme që kishin të gjithë për atdheun e vet, si edhe dashuria për Bashkimin Sovjetik. Kjo u bë një faktor shumë i rëndësishëm për afrimin e bashkëpunimin e ngushtë midis tyre dhe shërbeu si një shtytje e fundit për shkrirjen e grupeve në një parti të vetme komuniste. Tani «. . . u ndie më tepër se kurrë, sidomos nga poshtë, dëmi i madh që i vinte lëvizjes komuniste nga lufta e shterpët midis grupeve dhe nevoja urdhëruese për t'i dhënë fund kësaj lufte dhe për të realizuar konditat e nevojshme për njësinë e lëvizjes në Shqipëri»<sup>2</sup>.

Lufta kundër fashizmit, që do të siguronte bashkimin e komunistëve, mori përpjesëtime më të gjera. Dëshirën e komunistëve të bazës për të luftuar, pas agresionit hitlerian kundër BRSS nuk mund ta kundërshtonin as udhëheqësit e Grupit të Shkodrës, të cilët kishin pasë shfaqur pikëpamjen që «komunistët të hidheshin në luftë kur Bashkimi Sovjetik të hynte në Luftën e Dytë Botërore». Rolin kryesor në Grupin Komunist të Shkodrës po e luanin tani Vasil Shantoja e Qemal Stafa, që kishin filluar të bashkëpunonin me

---

1 Enver Hoxha. Fjalim në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, 15 prill 1944. Procesverbal i mbledhjes. AQP.

2 Rezolucion i Mbledhjes së Grupeve Komuniste. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 18.

Enver Hoxhën. Vija e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte bërë tashmë vija mbizotëruese edhe në këtë Grup. Në udhëzimet që u jepeshin në këtë kohë anëtarëve të Grupit thuhej midis të tjerave: «Si njerëz që doni vendin tuaj, hyni ndër masa, fitoni simpatinë e tyre, merruni vesh me to dhe i përgatisni për një lëvizje kombëtare me armë»<sup>1</sup>.

Të gjitha këto bënë të mundur të arrihej në marrëveshje, në gusht 1941, midis Grupit Komunist të Korçës e Grupit Komunist të Shkodrës për shkrirjen e tyre në një parti të vetme, që do të paraprihej nga organizimi e kryerja së bashku e një vargu veprimesh antifashiste. Me këtë marrëveshje më vonë u bashkua edhe Grupi i Të Rinjve, ndërsa Grupi i «Zjarrit» nuk iu përgjigj thirrjes për bashkëpunim. Ndër veprimet e përbashkëta antifashiste të grupeve më i rëndësishmi ishte demonstrata e madhe antifashiste në Tiranë më 28 tetor 1941, në përvjetorin e festës fashiste të «marshimit mbi Romë». Në të morën pjesë masa të gjera popullore të kryeqytetit. Organizatori kryesor i kësaj demonstrate ishte Enver Hoxha. Fashistët kundërvepruan egërsisht. Enver Hoxha, i ndjekur nga fashistët, u detyrua të hidhej në ilegalitet. Autoritetet fashiste e dënuan atë me vdekje në mungesë. Demonstrata e Tiranës ishte guri i provës për bashkimin e komunistëve shqiptarë. Ajo tregoi forcën e këtij bashkimi në zjarrin e luftës kundër fashizmit dhe rëndësinë e tij të madhe për mobilizimin e masave popullore në Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Demonstrata e Tiranës u pasua nga një demonstratë tjetër e madhe në Korçë më 8 nëntor 1941, e organizuar gjithashtu nga grupet komuniste, për të protestuar kundër arrestimeve në masë që bënë fashistët në kryeqytet. Ajo përfundoi në një përleshje të përgjakshme me karabinierinë dhe policinë fashiste. Aty u vra Koci Bako, anëtar i vjetër i Grupit të Korçës.

Suksesi politik i këtyre demonstratave ushtroi ndikim të madh në opinionin publik të vendit. Ato e rritën edhe më shumë emrin e komunistëve në popull. Suksesi i tyre, nga ana tjetër, i shqetësoi thellë autoritetet fashiste të pushtimit.

---

1 Udhëzim i Grupit të Shkodrës, drejtuar anëtarëve të vet. AQP.

Fashistët e kuptuan se kishin të bënë me një kundërshtar që po rritej e forcohej dhe po bëhej gjithnjë më kërcënues për ta.

Lufta e vetë komunistëve shqiptarë krijoi më në fund të gjitha kushtet për themelimin e partisë së tyre. Në gjirin e grupeve komuniste ishin rritur kadro revolucionarësh profesionistë, të cilët kishin mundur të ngriheshin mbi mosmarrëveshjet e grupeve, kishin përqaftuar vendosmërisht vijën e luftës pa kompromis kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit dhe kishin luftuar për bashkimin, mbi këtë bazë, të lëvizjes komuniste shqiptare. Këta kadro me luftën e tyre të palodhur e përgatitën ideologjikisht dhe organizativisht formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë.

Lufta antifashiste e komunistëve të grupeve të ndryshme e kishte tronditur nga themelet sektarizmin dhe frymën e grupit që pat mbizotëruar deri atëherë. Kjo luftë e përbashkët u bë faktor vendimtar që midis grupeve kryesore komuniste të arrihej marrëveshja për shkrirjen e tyre dhe për organizimin, më në fund, të një mbledhjeje me përfaqësues nga të gjitha grupet, e cila do të zgjidhte çështjen e themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë.

## 5. THEMELIMI I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

Mbledhja e Grupeve Komuniste për themelimin e Partisë u mbajt më 8-14 nëntor 1941 në ilegalitet në Tiranë. Në të merrnin pjesë 15 veta. Ndërmjet tyre ishin Enver Hoxha, Qemal Stafa, Vasil Shanto, Pilo Peristeri e të tjerë.

Detyra kryesore, për të cilën ishte organizuar Mbledhja, u zgjidh në parim qysh në fillim. Më 8 nëntor u mor vendimi historik për shkrirjen e grupeve dhe themelimin e **Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH)**.

Në Mbledhje u dëgjuan raportet mbi veprimtarinë e secilit grup, u vunë në dukje sukseset dhe të metat e lëvizjes komuniste në Shqipëri dhe u rrahën problemet jetësore që i dilnin Partisë.

Shumica e përfaqësuesve shprehën vendosmërinë për t'i dhënë fund përçarjes dhe për të ndërtuar një parti të vetme marksiste-leniniste, me një unitet të shëndoshë organizativ dhe ideologjik dhe me një vijë politike luftarake.



Vetëm Anastas Lula e Sadik Premtja, udhëheqësit kryesorë e përfaqësues të Grupit të Të Rinjve, u munduan të pengonin arritjen e këtij pikësynimi. Ata nuk guxuan të shpreheshin hapur kundër bashkimit të grupeve komuniste, sepse një bashkim i tillë kërkohet me këmbëngulje nga populli. Por paraqitën dhe mbrojtën pikëpamjet e njohura trockiste të Grupit të tyre dhe të tradhtarëve të tjerë të marksizëm-leninizmit. U përpoqën të vërtetonin sidomos «mungesën e proletariatit», «karakterin reaksionar dhe konservator të fshatarësisë», «mungesën e kuadrove të përgatitur», «rrezikshmërinë që paraqiste për kuadrot propaganda dhe agjitacioni i hapët kundër fashizmit», «kotësinë për t'u mbështetur në ndihmën e përkrahjen e Bashkimit Sovjetik!»! Me këto ata synonin të krijonin idenë se formimi i një partie të vetme komuniste do të ishte një gjë formale dhe se kjo parti nuk do të arrinte kurrë të bëhej udhëheqëse e popullit shqiptar e të drejtonte luftën për çlirimin kombëtar.

Kundër këtyre tezave likuidatore u zhvillua një luftë parimore, të cilën e udhëhoqi Enver Hoxha, i përkrahur nga Qemal Stafa dhe pjesëmarrës të tjerë të mbledhjes që qëndronin në pozita marksiste-leniniste. Kur e panë veten të mundur, Anastas Lula e Sadik Premtja pranuan sa për sy e faqe t'i nënshtroheshin shumicës dhe dhanë fjalën se do të zbatonin vendimet e mbledhjes.

Mbledhja e Grupeve Komuniste përcaktoi bazat ideologjike dhe organizative të Partisë dhe përpunoi çështjet themelore të vijës së saj të përgjithshme për periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Për udhëheqjen e Partisë u zgjodh Komiteti Qendror (i përkohshëm) prej 7 vetash. Për drejtimin e tij u ngarkua Enver Hoxha, ndonëse nuk u caktua asnjë sekretar.

Sipas kushtit të pranuar, në udhëheqjen e Partisë nuk hyri asnjëri nga ish-krerët kryesorë (kryetari dhe zëvendësi) të grupeve. Kjo nuk ishte pasojë e një marrëveshjeje të thjeshtë, por një kërkesë e zhvillimit të lëvizjes komuniste dhe revolucionare. Krerët e grupeve, të mbrojtur me një frymë të theksuar grupazhi, për një kohë të gjatë ishin bërë pengesë e madhe për bashkimin e komunistëve shqiptarë në një parti të vetme dhe ishin treguar të paaftë për të drejtuar komunistët dhe masat revolucionare.

## Bazat ideologjike dhe organizative të Partisë

Mbledhja dënoi pikëpamjet social-demokrate mbi partinë e klasës punëtore, që ishte munduar t'i përhapte në Shqipëri sidomos Llazar Fundoja; demaskoi vijën dhe veprimtarinë kryekëput trockiste të Grupit të «Zjarrit», i cili përpiqej të ligjësonte veten si «parti komuniste shqiptare» dhe vendosi në mënyrë të prerë që Partia Komuniste e Shqipërisë të organizohej e të forcohej si një parti e tipit të ri: «Partia nuk do të bëhet parti e tipit të vjetër, parti e ngjashme me ato të Ndërkombëtares së Dytë socialdemokrate, në të cilën mbretëronte brejtja, mospunimi, tarafilëku, fraksionazhi dhe tradhtia e interesave të klasës punëtore. Duam një parti. . . , e cila do të jetë e zonja të udhëheqë klasën punëtore në luftë deri në fitim. . . »<sup>1</sup>.

Në të njëjtën kohë mbledhja goditi të gjitha pikëpamjet e gabuara e të huaja për ideologjinë marksiste-leniniste që kishin zënë vend në radhët e grupeve komuniste. Në mënyrë të posaçme u dënua «teoria e kuadrove» si disfatiste dhe oportuniste, që i largonte komunistët nga masat e popullit, i mban-te në bisht të tyre, i kthente në një sekt dhe që çonte më në fund në asgjësimin e Partisë.

Si teori pararojë, prej së cilës do të udhëhiqej Partia në përpunimin e programit dhe në gjithë veprimtarinë e vet, u përcaktua marksizëm-leninizmi. Lidhur me këtë u vu detyrë: «Duhet të ngulim këmbë energjikisht për lartësimin ideologjik teorikisht e politikisht të kuadrove, duke mësuar teorinë marksiste-leniniste. . . »<sup>2</sup>.

Komiteti Qendror i përkohshëm u ngarkua të pastronte gjithë letërsinë e grupeve komuniste nga materialet antimarksiste, trockiste e anarkiste dhe të organizonte botimin në gjuhën shqipe, shpërndarjen dhe studimin e «Kursit të shkurtër të historisë së Partisë Komuniste (Bolshevike) të BRSS», si edhe të një numri veprash të K. Marksit, F. Engelsit, V. I. Leninit dhe J. V. Stalinit.

---

1 Rezolucioni i Mbledhjes së Grupeve Komuniste. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 23.

2 Po aty, f. 24.

Në këtë mënyrë Partia Komuniste e Shqipërisë që në fillim ngriti lart rëndësinë e teorisë marksiste-leniniste e të ndërgjegjes komuniste të anëtarëve të saj, si një forcë që i jep jetë e gjallëri, i hap perspektiva dhe i tregon rrugën e fitores lëvizjes punëtore, lëvizjes çlirimtare të masave të shtypura e të shfrytëzuara.

Mbledhja vendosi t'i jepej fund njëherë e mirë gjendjes së kalbët organizative të grupeve komuniste, disiplinës së dobët, frymës së fraksionit dhe të grupazhit dhe të krijohej një parti mbi baza të shëndosha organizative marksiste-leniniste. Organizimi i shëndoshë u quajt si mjeti kryesor që do ta bënte të pathyeshme Partinë e do të siguronte zbatimin e vijës së saj politike.

Detyrë e parë u vu dorëzimi në Komitetin Qendror të përkohshëm i të gjitha lidhjeve që kishin udhëheqjet e grupeve komuniste me anëtarët e tyre. Këtej e tutje komunistët ishin të detyruar të zbatonin vetëm normat organizative të përcaktuara nga Mbledhja dhe nga Komiteti Qendror mbi bazën e parimit të centralizmit demokratik, që është parim themelor i organizimit për një parti marksiste-leniniste.

Në vend të celulave të vjetra, të ngushta, prej dy-tre vetash, u dha direktivë të krijoheshin brenda një kohe sa më të shkurtër celula të reja. Në to do të hynin ish-anëtarët e grupeve, pasi të bëhej më parë shoshitja e radhëve të tyre. Ata që kishin shfaqur prirje të theksuara sektarizmi, oportunizmi e grupazhi do të ngeleshin jashtë. Krahas organizimit të celulave, do të formoheshin komitetet qarkore të partisë. Midis komiteteve e celulave duhej të mbaheshin lidhje të forta. Mbledhja kërkonte që celulat të tregonin sa më tepër iniciativë, të hynin në masat e gjera të qytetit e të fshatit dhe që komitetet t'i ndihmonin dhe të kontrollonin vazhdimisht veprimtarinë e tyre.

Në të njëjtën kohë, për forcimin e Partisë u gjykua e domosdoshme shtimi i radhëve me anëtarë të rinj, me luftëtarë të vendosur, punëtorë e fshatarë të varfër, duke zhdukur frikën dhe sektarizmin për pranimin e tyre.

Për anëtarësinë në Parti u pranua formulimi i njohur i V. I. Leninit që mbledhja e hartoi kështu: «Anëtar i partisë mund të jetë vetëm ai që pranon programin, që bën pjesë

aktive në një organizatë të partisë (celulë) e paguan kuotizacionin»<sup>1</sup>.

Një vëmendje veçanërisht e madhe iu kushtua unitetit dhe disiplinës së partisë. «Pa një disiplinë çeliku dhe njësinë e partisë, Partia jonë, e cila ka një numër të madh armiqsh, nuk do të mund ta udhëhiqte me sukses luftën»<sup>2</sup>.

Për të siguruar një unitet të shëndoshë dhe disiplinë të fortë kërkohej që komunistët të mbanin sytë hapur për të mos lejuar depërtimin në radhët e Partisë të elementëve karrieristë, ngatërrestarë me frymë të theksuar mikroborgjeze, që nuk e durojnë disiplinën dhe krijojnë shesh për punë antiparti. Njëkohësisht ngarkoheshin organizatat e partisë të largonin pa ngurrim nga radhët e veta cilindo qoftë me prirje antimarksiste, oportuniste, likuidatore. U theksua se tarafi, grupazhi, fraksioni, mungesa e disiplinës nuk mund të kenë vend në Parti.

Një çështje themelore, që diskutoi dhe vuri në rendin e ditës Mbledhja, ishte lidhja e Partisë me masat. U kërkua me këmbëngulje që sëmundja e grupeve në këtë çështje të zhdukej patjetër.

Mbledhja i porositi komunistët shqiptarë të mos i harrojnë asnjëherë fjalët e J.V.Stalinit: «Po të mos ndahen nga populli, nga nëna e cila i ka lindur, komunistët do të jenë të pathyeshëm»<sup>3</sup>.

Për t'u lidhur me masat e gjera të qytetit e të fshatit, të rinisë e të grave, për t'i bindur ato në drejtësinë e vijës politike të Partisë, Mbledhja u tregonte komunistëve këtë rrugë: të zhvillohej propagandë e agjitacion luftarak e i dendur me të gjitha shtresat e popullit; të kryheshin veprime politike dhe luftarake sa më gjallërisht që të ishte e mundur; të shoqëroheshin puna politike sqaruese dhe veprimet politike e luftarake me organizimin e masave nga ana e Partisë.

Që të siguroheshin lidhje të shëndosha me masat, Mbledhja kërkonte të bëhej kthesë në punën me rininë dhe me gratë, të zhdukej ngathtësia, sektarizmi e gabime të tjera që

---

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 24.

2 Po aty, f. 25.

3 Po aty, f. 23.

kishin grupet në këtë punë. Komiteti Qendror i përkohshëm u ngarkua të krijonte sa më shpejt organizatën e Rinisë Komuniste, nëpërmjet së cilës do të mobilizohej në luftën antifashiste gjithë rinia shqiptare. Ndërkohë, me gratë vihej detyrë të bëhej një punë e vëmendshme, të futeshin në Partia punonjëse dhe të mobilizohej në luftën çlirimtare masa femërore e popullsisë.

Mbledhja i kushtoi gjithashtu kujdes të veçantë ruajtjes së Partisë nga goditjet e armiqve që do të bënin çmos për ta shkatërruar atë. Pushtuesit fashistë italianë dhe shërbëtorët e tyre shqiptarë do ta drejtonin grushtin kryesor kundër Partisë Komuniste më fort se kundër grupeve. Ata ndihmoheshin në këtë drejtim edhe nga trockistët e Grupit të «Zjarrit», nga të gjithë renegatët e komunizmit. Për këtë arsye në Mbledhje u vu detyrë të tregohej një vigjilencë e lartë nga ana e anëtarëve të partisë, të ruheshin me çdo kusht sekretet e partisë, të zbatoheshin një konspiracion i plotë, të mësohej Partia të punonte në kushtet e një ilegaliteti të thellë. Lidhur me këtë u dënuan ashpër pikëpamjet e disa oportunistëve e tradhtarëve në radhët e grupeve që thoshnin se komunistët, kur ndodhen përballë torturave, mundet edhe të kallëzojnë në polici e karabinieri, pa bërë ndonjë tradhti. Këto u cilësuan si pikëpamje të huaja për partinë e proletarietit dhe që duheshin zhdukur pa mëshirë.

Duke kërkuar një konspiracion të madh nga komunistët, njëkohësisht Mbledhja tërhoqte vëmendjen që kjo çështje të kuptohet drejt dhe të mos bëhej shkak për të kufizuar veprimtarinë me masat. «Ne kemi konspiracion për të ruajtur organizatën kundër armikut të klasës dhe jo për t'u fshehur prapa perdes e për t'u mbyllur në vetvete»<sup>1</sup>.

## **Vija politike për Luftën Nacionalçlirimtare**

**Grupeve Komuniste. Si qëllim strategjik i Partisë për periudhën historike, në të cilën ndodhej vendi, u përcaktua: Të luftohet për pavarësinë kombëtare të popullit shqiptar dhe**

**Vija politike e Partisë gjeti mishërimin e vet në detyrat politike që përpunoi Mbledhja e**

---

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 25.

## për qeverinë popullore demokratike, në një Shqipëri të lirë prej fashizmit<sup>1</sup>.

Ky qëllim strategjik u përcaktua në bazë të kontradiktës themelore antagonistike që ekzistonte në atë kohë në Shqipëri dhe që kërkonte zgjidhje të ngutshme, për të thyer pengesat që ndalonin zhvillimin shoqëror, ekonomik dhe kulturor kombëtar: kontradikta midis popullit dhe pushtuesve fashistë. Ekzistonte edhe kontradikta tjetër: midis masave popullore dhe klasave shfrytëzuese, por kjo në atë kohë kishte kaluar në plan të dytë. Megjithatë, në kushtet konkrete kjo kontradiktë nuk mund të zgjidhej veças nga kontradikta themelore antagonistike, për arsye se çifligarët, bajraktarët dhe borgjezia reaksionare përbënin mbështetjen shoqërore të pushtuesve në vend. Interesat e klasave kryesore shfrytëzuese të vendit ishin të lidhura ngushtë me interesat e pushtuesve fashistë. Prandaj, plotësimi i qëllimit strategjik të Partisë nuk mund të mos prekte edhe interesat e këtyre klasave, vegla të skllavëruese të huaj.

Sundues fuqiplotë në Shqipëri ishin **fashistët italianë**, rrjedhimisht, këta ishin edhe **armiqtë kryesorë** të popullit shqiptar në atë kohë. Kurse të gjithë ata që kishin marrë anën e pushtuesve dhe ishin vënë në shërbim të tyre për të shtypur popullin shqiptar u cilësuan si tradhtarë, si vegla të fashizmit dhe kundër tyre u shpall luftë njësoj si kundër pushtuesve.

Forcat kryesore dhe më të interesuara për arritjen e qëllimit strategjik ishin **punëtorët e fshatarët**, mbi kurrizin e të cilëve rëndonte pesha më e madhe e robërisë fashiste. Për këtë arsye Partia përcaktoi si njërin nga detyrat më të rëndësishme të saj «të krijohet dhe të zgjerohet njësi luftarake në mes të masave punonjëse të qytetit e të fshatit»<sup>2</sup>.

Për sigurimin e pavarësisë kombëtare ishin të interesuara gjithashtu edhe shtresat jopunonjëse patriotike. Prandaj Partia nuk mund t'i linte mënjane këto shtresa dhe vuri detyrë të punohej pa pushim për t'i mobilizuar në Lëvizjen Nacional-

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 26 (nënvizimi i Red).

2 Po aty.

çlirimtare. «...Të bashkohemi me të gjithë nacionalistët<sup>1</sup> që duan me të vërtetë Shqipërinë e lirë, me të gjithë shqiptarët e ndershëm që duan të luftojnë kundër fashizmit»<sup>2</sup>.

Me këtë hidhej ideja e frontit nacionalçlirimtar, ide që do të përpunohej më thellë dhe në formë më të përcaktuar e më konkrete gjatë zhvillimit të luftës.

Duke parashikuar që pushtuesit fashistë dhe reaksioni i brendshëm do të përdornin të gjitha mjetet për të mos lejuar bashkimin luftarak të popullit shqiptar, Mbledhja e Grupeve Komuniste porositi të demaskoheshin dhe të shkatërroheshin të gjitha manovrat e fashistëve italianë dhe të qeverisë kuislinge për të përçarë frontin nacionalçlirimtar të popullit shqiptar.

Kur u themelua Partia Komuniste, në Shqipëri nuk kishte asnjë parti politike antifashiste që të mund të përfaqësonte interesat e borgjezisë ose të ndonjë klase a shtrese tjetër. Megjithatë, Mbledhja në parim u shpreh për bashkëpunimin e Partisë Komuniste me parti të tjera politike antifashiste në çështjet e organizimit të luftës kundër pushtuesve, po që se parti të tilla do të formoheshin.

Për çlirimin e vendit dhe vendosjen e demokracisë popullore në Shqipëri Mbledhja e Grupeve Komuniste arriti në përfundimin se rruga e vërtetë dhe e sigurt në rrethanat konkrete ishte **kryengritja e armatosur** kundër fashizmit. Ajo vendosi: «...të përgatitim politikisht dhe ushtarakisht popullin drejt kryengritjes së përgjithshme me armë, duke përmblodhur në luftë të gjitha fuqitë patriotike dhe antifashiste»<sup>3</sup>.

Duke zgjedhur si formë kryesore të luftës kryengritjen e përgjithshme të armatosur, Partia nuk i la pas dore edhe format e tjera të luftës, grevat, demonstratat antifashiste, sabotimet, demaskimin me gojë e me shkrim të armiqve etj.

---

<sup>1</sup> **Nacionalistë** thirreshin zakonisht patriotët që e donin atdheun dhe kërkonin çlirimin e tij nga pushtuesit e huaj. Por **nacionalistë** e quanin veten edhe pseudopatriotët nga radhët e çifligarëve, të bajraktarëve dhe të borgjezisë reaksionare. Për këtë arsye patriotët e vërtetë, për të mos i ngatërruar me elementët reaksionarë e tradhtarë, quheshin edhe «nacionalistë të ndershëm», «nacionalistë patriotë».

<sup>2</sup> Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 14 (nënvizimi i Red.).

<sup>3</sup> Po aty, f. 26.

Por të gjitha këto forma kishin për qëllim të përgatisnin popullin për kryengritjen e përgjithshme me armë.

Organizimi i luftës së armatosur kërkonte medoemos edhe përgatitjen e **forcave të armatosura, të ushtrisë nacionalçlirimtare**. Mbledhja theksoi se pa krijimin e një ushtrie të vërtetë popullore, që të ishte e zonja të godiste pa ndërprerje armikun, të shkatërronte aparatën e tij ushtarak e politik as që mund të mendohej kryengritja e armatosur, as që mund të flitej për çlirimin e vendit, për fitoren e pavarësisë kombëtare dhe për vendosjen e një qeverie demokratike popullore.

Në rrethanat e pushtimit të Shqipërisë dhe të Luftës së Dytë Botërore nuk kishte mundësi që kryengritja e armatosur të ishte një shpërthim i vetëm dhe i menjëhershëm, që ushtria popullore revolucionare të krijohet menjëherë. Zhvillimi i kryengritjes së armatosur dhe krijimi i ushtrisë nacionalçlirimtare do të ishte një proces i tërë. Kjo ide pasqyrohej qartë në njërën nga detyrat politike që përcaktoi Mbledhja për organizimin e lëvizjes partizane, krijimin e njësiteve guerile dhe të çetave, si skelet i ushtrisë së ardhshme popullore dhe si bazë reale për përgatitjen e kryengritjes së përgjithshme.

Në përshtatje me qëllimin strategjik të saj dhe me kushtet që u krijuan në gjendjen ndërkombëtare pas hyrjes së Bashkimit Sovjetik në Luftën e Dytë Botërore, PKSH përcaktoi edhe aleatët e jashtëm të popullit shqiptar si edhe qëndrimin ndaj këtyre aleatëve.

Në shkallë ndërkombëtare Lufta Nacionalçlirimtare shqiptare ishte pjesë përbërëse e luftës botërore antifashiste. Populli shqiptar me luftën e tij duhej ta vinte veten në radhët e pjesëmarrësve më veprues të koalicionit të madh antifashist.

Lidhur me këtë Mbledhja e Grupeve Komuniste cilësoi si aleatë të popullit shqiptar në Luftën Nacionalçlirimtare Bashkimin Sovjetik, Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjithë popujt e robëruar që luftonin kundër armikut të përbashkët — fashizmit gjerman, italian e japonez. Ajo vuri detyrë **për ta lidhur Luftën Nacionalçlirimtare shqiptare me luftën e madhe botërore antifashiste**.

Partia e vlerësoi shumë drejt aleancën e Bashkimit Sovjetik me Britaninë e Madhe dhe SHBA si një aleancë ushtarake që e kërkonin rrethanat për të shpëtuar botën nga



rrreziku i robërimit fashist. Në të njëjtën kohë ajo bëri vlerësime të ndryshme të aleatëve dhe përcaktoi kundrejt tyre një qëndrim të diferencuar. Në radhë të parë «Luftën tonë Nacionalçlirimtare — i bënte thirrje popullit shqiptar Komiteti Qendror i përkohshëm i PKSH — ta lidhim ngushtë me luftën heroike të popujve të Unionit Sovjetik, që gjendet në ballë të luftës çlirimtare kundër fashizmit»<sup>1</sup>. PKSH e shikonte Bashkimin Sovjetik si aleatin besnik e të sigurt të popullit shqiptar që do ta ndihmonte atë edhe për vendosjen e forcimit e pushtetit popullor në Shqipëri. Kurse Britania e Madhe dhe SHBA ishin vetëm aleatë të përkohshëm në luftën kundër shteteve fashiste.

Mbledhja e Grupeve Komuniste për themelimin e Partisë vuri detyrë «të zhvillohet dashuria për Bashkimin Sovjetik», duke popullarizuar rolin pararojë në luftën kundër fashizmit e në të njëjtën kohë fitoret e tij të mëdha në ndërtimin e socializmit.

Ajo udhëzoi gjithashtu «të zhvillojmë dashurinë dhe bashkëpunimin luftarak me të gjithë popujt e Ballkanit, sidomos me popujt serb, grek, malazez e maqedonas»<sup>2</sup>, që ishin ngritur në luftën antifashiste çlirimtare.

Më në fund, Mbledhja shprehu bindjen se Partia e re Komuniste do të zhdukte brenda një kohe të shkurtër gjendjen e sëmurë në lëvizjen komuniste në Shqipëri, do ta vinte veten në radhët e para të luftës e do të bëhej e zonja për të kryer detyrat e mëdha historike, si udhëheqëse e popullit shqiptar për çlirimin e tij kombëtar e shoqëror.

Rëndësia historike e Mbledhjes së Grupeve Komuniste qëndron në faktin se ajo themeloi Partinë Komuniste të Shqipërisë, si një parti revolucionare marksiste-leniniste të klasës punëtore.

Ajo e armatosi Partinë me një program politik të qartë, që u përgjigjej kërkesave dhe dëshirave të masave të gjera të popullit, të atdheut, të socializmit. Ky program ende s'ishte i plotë dhe detyrat e caktuara nuk ishin përpunuar me im-

---

1 Thirrja e parë e KQ të PKSH, nëntor 1941. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 31.

2 Rezolucioni i Mbledhjes së Grupeve Komuniste. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 27.

tësi, sepse për ta bërë këtë nevojitej një përvojë më e gjerë e punës dhe e luftës revolucionare të Partisë e të masave popullore. Por ky program ishte ndërtuar mbi themele shkencore marksiste-leniniste.

Përfundimet e mbledhjes shënojnë fitoren e marksizëm-leninizmit mbi trockizmin dhe oportunizmin në lëvizjen punëtore dhe komuniste në Shqipëri.

Partia Komuniste e Shqipërisë, duke qenë në radhë të parë përfaqësuese e interesave të klasës punëtore, mori përsipër të mbronte njëkohësisht interesat e gjithë masave punonjëse, të popullit të robëruar të Shqipërisë. Prandaj themelimi i Partisë ishte një fitore e madhe e popullit shqiptar.

Për të gjitha këto arsye **Mbledhja e Grupeve Komuniste pati rëndësinë e një kongresi kushtetues.**